

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5775
E hënë, 13 maj 2019
çmimi 0.40 €

Pendarovski merr detyrën e presidentit të Maqedonisë së Veriut

FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", RAMUSH TAHIRI | FAQE 4-5

Qeveria mund të bjerë nga një koalicion pozitivë - opozitë

Politologu Ramush Tahiri ka bërë me dije se qeverinë Haradinaj nuk mund ta rrëzojë opozita aktuale. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se një mocion mosbesimi ndaj qeverisë mund të ndodhë vetëm nga një koalicion joparimor pozitivë - opozitë. Ai ka paralajmëruar

se edhe kryeministri Ramush Haradinaj mund ta ketë fatin e ish-kryeministrit Isa Mustafa i cili ishte rrëzuar me vota të partnerëve të tij qeverisës. Tahiri ka thënë se sapo PDK-ja ta sigurojë partnerin për qeverinë e ardhshme mund ta rrëzojë këtë qeveri



Shkruan: Bardhyl MAHMUTI

AKTUALE

**DICK MARTY
ËSHTE
SHËNDOSH E
MIRË SA HERË
DUHET TË
SHPIFË KUNDËR
SHQIPTARËVE F.11**



**AGJENCIA PËR MBROJTJEN
E MJEDISIT: DO TË MERREN
MASA LIGJORE PËR ATA
QË E VRASIN ARIUN F. 6**

**INSTITUTI
HIDROMETEOROLOGJIK
PARALAJMËRON VËRSHIME
TË MARTËN F. 6**



EKONOMI

**TAKSA 100 PËR QIND KA
NDIKUAR NË RRRITJEN E
ÇMIMEVE F. 8**

**DEFICITI TREGTAR SHËNON
ULJE PËR 2.1 PËR QIND F. 9**

SPORT

**VUSHTRRIA RIKTHEHET
NË SUPERLIGË,
AFËR EDHE DUKAGJINI F. 18**

**VUSHTRRIA RIKTHEHET
NË SUPERLIGË, AFËR EDHE
DUKAGJINI F. 18**

Ismaili zgjedhet kryetar i PDK-së në Prishtinë, synon qeverisjen e kryeqytetit

Me shumicë votash dhe pa kundërkandidat Uran Ismaili është zgjedhur kryetar i Degës së Partisë Demokratike të Kosovës në Prishtinë. Duke falënderuar delegatët për dhënien e besimit, ai ka thënë se përmbyllja e këtij procesi zgjedhor shënon edhe fillimin e detyrës që ka për t'i dhënë qytetit, vëmendjen dhe qeverisjen që meriton. Sipas Ismailit, PDK-ja është më e gatshme dhe më vitale për ta luftuar degradimin e Prishtinës. Ai ka shprehur përkushtimin për të punuar në çdo pjesë të Prishtinës që "Dekada



e Re" të jetë platforma e vetme për zgjidhjen e problemeve të kryeqytetit | FAQE 7



**Sot fillon
fushata
zgjedhore
për
zgjedhjet
lokale
në veri.** | FAQE 6

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Curëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Stevo Pendarovski sot (e hënë) nis punën si president i Maqedonisë së Veriut, duke zëvendësuar në këtë post Gjorge Ivanovin, i cili për dy mandate ishte president

Pendarovski merr detyrën e presidentit të Maqedonisë së Veriut

Presidenti i ri i Maqedonisë së Veriut, Stevo Pendarovski, fitues i zgjedhjeve presidenciale të 5 majit, është betuar të dielën para deputetëve dhe përfaqësuesve më të lartë të institucioneve shtetërore e fetare, se gjatë mandatit pesëvjeçar të tij do ta respektojë kushtetutën dhe ligjet në fuqi dhe se do ta mbrojë sovranitetin dhe integritetin territorial të Maqedonisë së Veriut

"Epoka e re"

SHKUP, 12 MAJ - Në Kuvendin e Maqedonisë të dielën është bërë inaugurimi i presidentit të ri të Maqedonisë së Veriut, Stevo Pendarovski, fitues i zgjedhjeve presidenciale, të mbajtura më 5 maj. Pendarovski është betuar para deputetëve dhe përfaqësuesve më të lartë të institucioneve shtetërore e fetare, se gjatë mandatit pesëvjeçar do ta respektojë Kushtetutën dhe ligjet në fuqi dhe se do ta mbrojë sovranitetin dhe integritetin territorial të Maqedonisë së Veriut.

Në seancën solemne kanë marrë pjesë edhe presidentë e përfaqësues të lartë të shumë shteteve, si presidenti i Shqipërisë e i Kosovës, Ilir Meta e Hashim Thaçi, presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, presidenti i Bullgarisë, Rumen Radev, ministrat e jashtëm të Greqisë dhe Malit të Zi si dhe zyrtarë tjerë të jashtëm. "Publikisht e them dhe obligohem se do të jem president i të gjithëve, edhe i atyre që votuan për mua, edhe i atyre që votuan për ndonjërin nga kundërkandidatët e mi, por edhe i atyre që për çfarëdo arsyeje nuk dolën të votojnë. Në sferën politike, punën e parë që do ta bëjë, e për të cilën shpeshherë kam folur gjatë dy muajve të kaluar, është shtrirja e dorës opozitës për bashkëpunim. E ndiej se përgjegjësia ime e parë si president që isha propozuar nga partitë në pushtet është që t'i mbroj të drejtat dhe statusin e pakicës, pasi demokracia ekziston vetëm kur të gjithë të jenë të barabartë nga veprimet e pushtetit", ka

deklaruar Pendarovski, duke theksuar edhe përkushtimin e tij për ruajtjen dhe zhvillimin e raporteve ndëretnike në shtet. "Raportet ndëretnike dhe baraspesha mes të gjitha etniteteve gjithmonë ka qenë fryt i stabilitetit dhe sigurisë tonë të brendshme. Problemi më i madh ka qenë dhe mbetet sjellja e partive më të mëdha politike, të cilat shpeshherë pozicionin e tyre ndaj raporteve ndëretnike e kanë shprehur varësisht nëse janë në pushtet apo opozitë, andaj edhe për çdo veprim apo sjellje do të kërkoj përgjegjësi politike", është shprehur kreu i ri i shtetit, duke u ndalur më parë në procesin e integritetit euroatlantik, si prioritet kryesor i qytetarëve të Maqedonisë së Veriut, për të ardhmen dhe zhvillimin e vendit. "Raportet e shkëlqyera me të gjitha pesë shtetet fqinje dhe bashkëpunimi i frytshëm rajonal janë parakushte themelore për zhvillimin e një shteti me pozitë specifike gjeografike. Marrëveshjet me Bullgarinë dhe Greqinë janë shembuj pozitivë dhe paraqesin guxim politik për lënien anash të stereotipave politike dhe ruajtjen e interesave nacionale dhe në të njëjtën kohë të promovohen interesat strategjike të shtetit", ka deklaruar Pendarovski. Ai në fjalimin e tij ka theksuar nevojën për ngritjen e ekonomisë së vendit dhe luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, krijimin e kushteve për parandalimit e ikjes së të rinjve nga vendi, pa të cilët, siç tha, shteti nuk mund të ketë të ardhme.

Në postin e presidentit, Stevo



Pendarovski zëvendëson kreun e deritanishëm Gjorge Ivanov, i cili për dy mandate ishte president i Maqedonisë së Veriut.

Pendarovski në zgjedhjet presidenciale fitoi kandidaten e opozitës Gordana Siljanovska-Davkova.

Presidenti Thaçi fton për vizitë zyrtare në Kosovë presidentin Stevo Pendarovski

Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka marrë pjesë në inaugurimin e presidentit të ri të Republikës së Maqedonisë Veriore, Stevo Pendarovski.

Presidenti Thaçi, pasi e ka uruar për detyrën e re presidentin Pendarovski, e ka ftuar atë që të punojnë së bashku për thellimin e bashkëpunimit rajonal. "Presidentit të zgjedhur të Maqedonisë Veriore dhe qytetarëve të Maqedonisë Veriore ua uroj marrjen e detyrës së presidentit edhe formalisht. Mirëpres bashkëpunimin drejt integritetit euroatlantik të vendeve tona", u shpreh presidenti Thaçi.

Presidenti Thaçi e ka ftuar presidentin e ri Pendarovski për vizitë zyrtare në Kosovë. Në ceremoninë e inaugurimit, presidenti Thaçi takoi edhe presidentin Ilir Meta të Shqipërisë, presidentin Rumen Radev të Bullgarisë, presidentin Aleksandar Vuçiq të Serbisë dhe zyrtarë të lartë të shteteve të tjera që morën pjesë në pritjen e organizuar në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë Veriore. Në të gjitha këto takime u theksua nevoja për marrëdhënie të mira dhe bashkëpunim ndërfqinjësor për të përshpejtuar integritetin e tërë rajonit në Bashkimin Evropian.

Meta dhe Pendarovski: Bashkë për integritetin evropian

I ftuar në Shkup për ceremoninë zyrtare të betimit të presidentit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Stevo Pendarovski, kreu i shtetit shqiptar, Ilir Meta, ka zhvilluar edhe një takim të veçantë me homologun e vet, të cilin e ka përgëzuar për fillimin e detyrës. Homologët Meta dhe Pendarovski theksuan rëndësinë e çeljes së negociatave për

anëtarësim në Bashkimin Evropian të të dy vendeve, si një mesazh i fuqishëm për perspektivën evropiane të të gjithë rajonit. "Neve na bashkon synimi i përbashkët i integritetit evropian të vendeve tona, rrugë gjatë së cilës mund të mbështetemi te njëri-tjetri", ka theksuar presidenti Meta.

Rama, mesazh Bashës: Ulemi dhe flasim për çdo nismë

TIRANË, 12 MAJ - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka thënë se opozita nuk mund ta rrëzojë qeverinë duke bërë thirrje për dhunë. Gjithashtu, shefi i qeverisë pretendon se në protestë do të shkojnë për herë e më pak njerëz, sepse ata nuk i besojnë

broçkullat e tyre. "Nuk ka shanse që të rrëzosh një qeveri legjitime, e dalë nga zgjedhjet ku ti ke qenë pjesë e qeverisë me këto forma. Nuk ka shanse, nuk ndodh. S'ka ndodhur askund dhe nuk do të ndodhë as këtu. E di që synimi është gjetkë. Është që të vendose

vendi në kushte pamundësie. Nuk jemi të pagabueshëm dhe as pa gabime, por jemi të vetmit që përpiqemi, pavarësisht se herë ia dalim e herë jo", ka thënë Rama, i cili ka shtuar se është i gatshëm të bëjë dialog me Lulzim Bashën. "Ulemi, flasim

dhe kthejmë në nisma ligjore shqetësimet që ata kanë për ta përmirësuar jetën e popullit, nëse kjo nuk është një luftë e ulët për të bërë një pazar. Të ulemi dhe të flasim për çdo shqetësim. Të ulemi, të flasim për çdo gjë, së ndryshe më herët



se vonë, turpi do t'i ndjekë pas gjithë kohës ata të cilët kanë ende mundësi që të kenë turp", ka thënë Rama.

Përfundon procesi zgjedhor i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) në Prishtinë

Ismaili zgjedhet kryetar i PDK-së në Prishtinë, synon qeverisjen e kryeqytetit

Me shumicë votash dhe pa kundërkandidat Uran Ismaili është zgjedhur kryetar i Degës së Partisë Demokratike të Kosovës në Prishtinë. Duke falënderuar delegatët për dhënien e besimit, ai ka thënë se përmbyllja e këtij procesi zgjedhor shënon edhe fillimin e detyrës që ka për t'i dhënë qytetit, vëmendjen dhe qeverisjen që meriton. Sipas Ismailit, PDK-ja është më e gatshme dhe më vitale për ta luftuar degradimin e Prishtinës. Ai ka shprehur përkushtimin për të punuar në çdo pjesë të Prishtinës që Dekada e Re të jetë platforma e vetme për zgjidhjen e problemeve të kryeqytetit



kryeqytet i një etniteti jugosllav jemi bërë shteti më i ri në hartën e botës. Politikanët dhe partitë asgjë nuk i kanë dhënë Prishtinës deri më tani. Kaosi, pasiguria, ajri i ndotur, urbanizimi i egër janë disa nocione që e karakterizojnë Prishtinën", ka deklaruar Hoxhaj.

Ndërsa nënkryetari i PDK-së, Hajredin Kuçi, ka paralajmëruar ardhjen e Kadri Veselit në krye të qeverisë pas fitores në zgjedhjet e ardhshme parlamentare. Ai ka thënë se fitorja e plotë e PDK-së dhe Kadri Veselit kryeministër bëhet kur PDK-ja do ta fitojë edhe Prishtinën. "Prishtina nuk është një rrugë, e një leje ndërtimi. Është pasqyra e Republikës së Kosovës për tërë vendin. Nuk ka qytetar i huaj që vjen në Kosovë e që nuk viziton Prishtinën. Asnjëherë s'jemi ndërjerë rehat pa e fituar Prishtinën. Urani do ta fitojë Prishtinën", ka thënë Kuçi.

**EPOKA
ERE**

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 12 MAJ - Uran Ismaili është zgjedhur kryetar i Degës së Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) në Prishtinë në Kuvendin Zgjedhor të së dielës ku kanë qenë të pranishëm zyrtarët më të lartë të kësaj partie. Ismaili ka thënë se pas përfundimit të këtij procesi zgjedhor ka një PDK të fortë që shtrihet në gjithë Prishtinën. Ndërsa numri i lartë i anëtarëve të rinj ai ka thënë se tregon se edhe qytetari i Prishtinës është më afër PDK-së. "Ndiej nevojën që Prishtina dhe PDK-ja të ndërtojnë një marrëdhënie të re mes tyre, që PDK-së ia jep një identitet të ri, kurse Prishtinës vëmendjen që meriton", ka thënë ai, duke shtuar se 75 nën-degët e formuara gjatë këtyre ditëve përbëjnë numrin më të madh të nën-degëve që PDK-ja

ka pasur ndonjëherë në Prishtinë. "Vullneti i fortë i partisë sonë, i kalitur në luftën çlirimtare dhe i formësuar në shumë fitore të zgjedhjeve, është dëshmi dhe frymëzim yni për të qenë parti e parë në Prishtinë. Ky kuvend, prania juaj, puna juaj dhe mijëra aderime, shënojnë një pikë kthese në rrugën tonë politike në Prishtinë. Prova të këtij mobilizimi janë qindra takime me këshilla iniciuese e mijëra qytetarë që iu përgjigjën thirrjes sonë", është shprehur Ismaili. Më tutje, ai ka theksuar se tashmë PDK-ja është më e gatshme dhe më vitale për ta luftuar degradimin e Prishtinës. "Prishtina ka shumë probleme dhe pak zhvillim. Ka shumë defekte dhe pak vizion. Ka shumë kokëçarje dhe pak ide për ta nxjerrë atë nga humnera e trafikut të paralizuar urban, nga kaosi arkitekturor që ka

lënë shumë dritare pa rreze të diellit, nga vrazhdësia e betonit që ka shtypur brutalisht çdo hapësirë të gjelbër, nga ajri i ndotur që shkurton jetë dhe nga shëmtia e mbeturinave që na turpëron. Ky është realiteti i dhimbshëm për secilin që merr frymë në Prishtinë, për çdo fëmijë dhe të rritur, për çdo person dhe familje, për çdo çift dhe shtëpi. Prishtina nuk mund të vazhdojë më kështu. Ajo i ka të gjitha atributet për zhvillim të madh. Gjendja aktuale e Prishtinës nuk është e drejtë dhe duhet të ndryshohet. Partia Demokratike e Kosovës do ta krijojë një klimë që i hap rrugë ndryshimit të madh", ka deklaruar Ismaili. Ai ka thënë se platforma e Dekadës së Re është zgjidhja për kryeqytetin dhe ajo do të jetësohet prandaj, sipas tij, Prishtina meriton më

mirë dhe PDK mund të ofrojë e punojë më shumë. "Ky edhe është synimi i Dekadës së Re për Prishtinën. Një transformim i PDK-së dhe i Prishtinës. Një periudhë e re plot përkushtim, vëmendje dhe përmirësim", është shprehur Ismaili në Kuvendin Zgjedhor të PDK-së në Prishtinë.

Ndërsa zëvendëskryetari i PDK-së, Enver Hoxhaj, ka thënë se Kosovës do t'i kthehet shpresa kur në krye të Qeverisë të jetë Kadri Veseli kryeministër e udhëheqjen e Prishtinës ta marrë kandidati për kryetar të PDK-së në kryeqytet, Uran Ismaili. Sipas Hoxhajt, deri më tani politikanët dhe partitë që kanë udhëhequr Prishtinën nuk i kanë dhënë asgjë kryeqytetit. "Prishtina i ka dhënë shumë Kosovës. Shumë zhvillime kanë filluar në Prishtinë dhe nga një

mirë dhe PDK mund të ofrojë e punojë më shumë. "Ky edhe është synimi i Dekadës së Re për Prishtinën. Një transformim i PDK-së dhe i Prishtinës. Një periudhë e re plot përkushtim, vëmendje dhe përmirësim", është shprehur Ismaili në Kuvendin Zgjedhor të PDK-së në Prishtinë. Ndërsa zëvendëskryetari i PDK-së, Enver Hoxhaj, ka thënë se Kosovës do t'i kthehet shpresa kur në krye të Qeverisë të jetë Kadri Veseli kryeministër e udhëheqjen e Prishtinës ta marrë kandidati për kryetar të PDK-së në kryeqytet, Uran Ismaili. Sipas Hoxhajt, deri më tani politikanët dhe partitë që kanë udhëhequr Prishtinën nuk i kanë dhënë asgjë kryeqytetit. "Prishtina i ka dhënë shumë Kosovës. Shumë zhvillime kanë filluar në Prishtinë dhe nga një



Flet për "Epokën e re", Ramush Tahiri

Qeveria mund të bjerë nga n



Politologu Ramush Tahiri ka bërë me dije se qeverinë Haradinaj nuk mund ta rrëzojë opozita aktuale. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se një mocion mosbesimi ndaj qeverisë mund të ndodhë vetëm nga një koalicion joparimor pozitë - opozitë. Ai ka paralajmëruar se edhe kryeministri Ramush Haradinaj mund ta ketë fatin e ish-kryeministrit Isa Mustafa i cili ishte rrëzuar me vota të partnerëve të tij qeverisës. Tahiri ka thënë se PDK-ja në momentin që e siguron partnerin për qeverinë e ardhshme mund ta rrëzojë këtë qeveri

Më tej, ai ka kritikuar edhe qasjen e opozitës ndaj qeverisë. Sipas Tahirit, opozita e vendit është e përçarë dhe kryeneçe. "Opozita është e përçarë dhe kryeneçe, në këtë rast Lëvizja Vetëvendosje dhe LDK-ja. Vetëvendosja jeton në revolucionarizëm, i cili është anakronik për kohën e sotme, kurse LDK-ja jeton në shpirt të Rugovës dhe në të kaluarën e saj, pa ndonjë plan strategjik për të ardhmen dhe pa ndonjë reformim të thellë. Pra, është një politikë meskine e këtyre dy partive", është shprehur Tahiri.

"Epoka e re": Z. Tahiri, zërat për rrëzimin e qeverisë disi janë qetësuar. Me heshtjen e taksës u hesht edhe kjo çështje. Pse po ndodh kjo?

Tahiri: Qeveria Haradinaj prej se është themeluar është përcjell me telashe. Siç e dimë me shumë vështirësi ka arritur t'i sigurojë 61 vota për t'u zgjedhur në Kuvend. Pavarësisht prej sfidave që pati, kjo qeveri në

qershor i bënë dy vjet të funksionimit të saj. Kjo është një qeveri e pakicës dhe zakonisht qeveritë e pakicës nuk zgjasin më shumë se një vit, duke llogaritur në parimet. Mirëpo në Kosovë, sidomos prej pavarësisë e këndeje, asnjëherë nuk janë respektuar parimet dhe asnjëherë partitë politike nuk kanë pasur strategji dhe plane afatgjatë për asnjë lëmë. Tani kjo qeveri mund të rrëzohet jo prej votave të opozitës, por prej një koalicioni joparimor pozitë - opozitë ashtu siç është rrëzuar qeveria Mustafa. Kushtet janë për t'u rrëzuar kjo qeveri, ose të vazhdojë në këtë mënyrë që po shkon. E gjitha varet prej deputetëve të cilët tani e kanë edhe interesin pragmatik, sepse pas dy vjetëve mandat u njihet e drejta që pastaj ta marrin pagën edhe për një vit. Nëse deputetët duan ta rrëzojnë qeverinë në muajin qershor, zgjedhjet mund të mbahen në vjeshtë. Se sa mund të ndodhë kjo, nuk

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 12 MAJ - Politologu Ramush Tahiri ka paralajmëruar se kryeministri Ramush Haradinaj mund ta ketë fatin e ish-kryeministrit Isa Mustafa. Ai ka thënë se qeveria aktuale mund të rrëzohet vetëm nga një koalicion joparimor pozitë - opozitë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Tahiri ka kritikuar qeverinë dhe subjektet opozitare. "Tani

kjo qeveri mund të rrëzohet jo prej votave të opozitës, por prej një koalicioni joparimor pozitë - opozitë, ashtu siç është rrëzuar qeveria Mustafa", ka thënë Tahiri. Ai ka deklaruar se në momentin që PDK-ja siguron partnerin politik për qeverinë e ardhshme, ajo mund ta rrëzojë qeverinë. Sipas Tahirit, një bashkëpunim PDK - LDK mund ta çojë vendin në zgjedhje të reja. "Tani ka mbetur të bëhet vetëm një marrëveshje e fshehtë PDK - LDK dhe qeveria

bie nesër. Kjo nuk është një strategji, por interes pragmatik. Bisedimet në këtë bazë janë duke u zhvilluar. Në atë moment që PDK-ja e siguron një mbështetje për ta krijuar qeverinë pas zgjedhjeve me LDK-në, menjëherë ajo e rrëzon qeverinë. PDK-ja nuk ka asnjë interes të qëndrojë në qeveri dhe për ta forcuar Ramush Haradinajn, ose për t'i duruar kritikën publike të Haradinajt derisa janë në koalicion bashkë", ka thënë Tahiri.

Një koalicion pozitiv - opozitë



shoh ndonjë interes, sepse ende nuk kemi parë ndonjë koalicion parimor parazgjedhor.

"Epoka e re": Si e keni parë funksionimin e partnerëve të koalicionit qeverisës gjatë këtyre dy vjetëve?

Tahiri: E kam parë si një garë për ta zhvatur shtetin. Pra, partnerët e koalicionit qeverisës bëjnë garë për të kapur shtetin dhe për të hyrë në të gjitha institucionet e saj. Këta partnerë kanë ndarë të gjitha këto. Shembull, një subjekt që i ka vetëm dy deputetë, AKR-ja, i ka marrë katër ministri. Këta ministra ky subjekt politik mund t'i ndërrojë pa e pyetur fare kryeministrin. Gjithashtu, këta partnerë i zënë agjencitë e pavarura, bordet e ndërmarrjeve publike, tenderët dhe kështu me radhë. Po flas vetëm këtë anën negative.

"Epoka e re": Meqenëse po e thekson anën negative të këtij koalicioni, cila është përgjegjësia e opozitës për ta ndalur këtë trend të pushtetit?

Tahiri: Opozita është e përçarë dhe kryeneçe, në këtë rast Lëvizja Vetëvendosje dhe LDK-ja. Vetëvendosje jeton në revolucionarizëm, i cili është anakronik për kohën e sotme, kurse LDK-ja jeton në shpirt të Rugovës dhe në të kaluarën e saj, pa ndonjë plan strategjik për të ardhmen dhe pa ndonjë reformim të thellë. Pra, është një politikë meskine e këtyre dy partive.

"Epoka e re": Mendoni se ky mosunitet i opozitës po e dobëson atë karshi pushtetit?

Tahiri: Partitë politike duhet të kenë dallime dhe kjo është normale. Madje edhe kur të hyjnë në koalicione partitë duhet t'i ruajnë dallimet e tyre, por ato duhet ta bëjnë një plan për pikat që janë takuese dhe urgjente për shtetin. Mirëpo partitë tona nuk i kanë këto elemente. Ato nuk kanë strategji. Tani ka mbetur të bëhet vetëm një marrëveshje e fshehtë PDK - LDK dhe qeveria bie nesër. Kjo nuk është një strategji, por interes pragmatik dhe bisedimet në këtë bazë janë duke u zhvilluar. Në atë moment që PDK-ja e siguron një mbështetje për ta krijuar qeverinë pas zgjedhjeve me LDK-në, menjëherë ajo e rrëzon qeverinë. PDK-ja nuk ka asnjë interes të qëndrojë në qeveri dhe për ta forcuar Ramush Haradinajn, ose për të duruar kritikën publike të Haradinajt derisa janë në koalicion bashkë.

"Epoka e re": Së fundi nënkryetarët e PDK-së, Enver Hoxhaj dhe Hajredin Kuçi, kanë filluar t'i drejtohen kryetarit të PDK-së, Kadri Veselit, si kryeministër i ardhshëm i Kosovës. A mund të interpretohet kjo si shenjë për zgjedhje të reja?

Tahiri: Para zgjedhjeve të fundit PDK-ja, edhe i ka pas shtypur bluzat me emrin e Veselit kryeministër, kur e bë

marrëveshja që kryeministër i koalicionit të jetë Haradinaj, e harroi këtë punë. Do të thotë, nuk ka asgjë prej kësaj pune. Është problem t'i bëjë numrat Veseli për t'u bërë kryeministër në këtë konstelacion partish. Këto pretendime janë vetëm për konsumim të brendshëm dhe propagandë për ta mbajtur partinë. Secila parti kur dëshiron të hyjë në zgjedhje thotë se do ta ketë kryeministrin dhe se nuk do të bëjë kompromise për këtë çështje.

"Epoka e re": Sa mund të jetë përcaktues fati i këtij koalicioni me qëndrimet e presidentit Thaçi dhe kryeministrin Haradinaj për çështjen e dialogut me Serbinë?

Tahiri: Dialogu me Serbinë është duke u shfrytëzuar për popull dhe po hedhen teza të ndryshme. Sikurse që ndodhi me demarkacionin me Malin e Zi pas hedhjes së gazit në Kuvend dhe atyre tensioneve që ndodhën. U harrua demarkacioni? Atëherë kryeministri shkante dhe takonte rugovasi dhe të tjerët, por tani më nuk ka shkuar në kufij me Malin e Zi. Pra, nuk është se në këtë proces do të këmbehen territoret, do të lëvizë kufiri apo se Kosova do të japë diçka. Krejt kjo është e kotë, sepse deri më tani nuk kemi ndonjë dokument që i parasheh këto. Pra, deri më tani çështja e dialogut me Serbinë dhe çështja e taksës po shfrytëzohet politikisht.

Thaçi: Kemi mbështetjen e ShBA-së për marrëveshjen e paqes me Serbinë

PRISHTINË, 12 MAJ (ER) - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka pritur në fundjavë në Prishtinë kongresistin amerikan Ed Case. Gjatë këtij takimi, presidentit Thaçi ka thënë se Kosova ka mbështetjen e plotë të Shteteve të Bashkuara në synimin për arritjen e një marrëveshjeje përfundimtare të paqes me Serbinë. "Republika e Kosovës mbetet e përkushtuar për paqe dhe stabilitet të qëndrueshëm në rajon, duke ndërtuar marrëdhënie të mira me fqinjët dhe duke punuar për marrëveshje përfundimtare të paqes me Serbinë. Në këtë synim e kemi mbështetjen e plotë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës", ka thënë Thaçi, duke shtuar se roli i ShBA-së

për Kosovën dhe rajonin mbetet qendror.

Kongresisti amerikan Ed Case është takuar edhe me kryeministrin Ramush Haradinaj. Kryeministri Haradinaj ka thënë se ky takim ishte moment i veçantë për të diskutuar rreth raporteve të shkëlqyera që ka Kosova me ShBA-në dhe për ta shprehur mirënjohjen e thellë për ndihmën e tyre në të gjitha proceset e vendit. "Kongresisti Case konfirmoi se Shtetet e Bashkuara mbeten partner i palëkundur i Kosovës dhe krenohet me shërbimet që anëtarët e Gardës Kombëtare të Hawai-it i ofrojnë KFOR-it. Kosova është jashtëzakonisht me fat që ka miq të vërtetë anëmbanë botës!", ka thënë Haradinaj.



IKD-ja: Lufta për kryeprokurorët, sfidë për pavarësinë e sistemit prokurorial

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

PRISHTINE, 12 MAJ - Sistemi gjyqësor dhe ai prokurorial në vitet e fundit janë ballafaquar me vështirësi në hartimin e legjislacionit sekondar dhe zbatimin e tij në mënyrë të drejtë dhe të paanshme në proceset e selektimit dhe procesit të emërimit apo propozimit për emërim të kryetarëve të gjykatave dhe kryeprokurorëve. Kështu është vlerësuar në një komunikatë për media të Institutit të Kosovës për Drejtësi (IKD). Sipas IKD-së, procesi i emërimit të kryeprokurorit aktual të Shtetit ishte subjekt i kritikave si nga publiku, media ashtu edhe nga faktori ndërkombëtar. "Sistemi prokurorial nuk po arrin ta fitoj besimin e publikut për të udhëhequr proces transparent, të paanshëm, të bazuar në meritën e kandidatit për pozitë kyçe në sistemin prokurorial të Kosovës. Kjo bazohet në faktin se proceset e zgjedhjes, propozimit dhe emërimit të kryeprokurorëve, kanë ndërtuar një praktikë të keqe në zvarritjen e procedurave, duke filluar prej praktikës së zvarritjes së më shumë se një viti të zgjedhjes së kryeprokurorit aktual të Shtetit, Aleksandër Lumezi, deri te procesi i fundit i konkursit për zgjedhjen e kryeprokurorit të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, i cili u anulua më 25 prill 2019", është theksuar në këtë komunikatë.

Sipas IKD-së, konkursi i anuluar më 25 prill 2019 për kryeprokuror të PSRK-së ishte shpallur para afër dy muajve, përkatësisht më 1 mars 2019. "Tetë ditë para shpalljes së këtij konkursi KPK-ja kishte ndryshuar Rregulloren për Emërimin e Kryeprokurorëve. Në këtë konkurs kishin konkurruar katër kandidatë, të cilët i plotësonin kriteret ligjore. KPK-ja për këtë konkurs të zgjedhjes së kryeprokurorit të PSRK-së themeloi Komisionin për Vlerësimin e Kandidatëve. Komisioni i themeluar përbëhej nga tre anëtarë (Kryesuesi i Komisionit nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit dhe dy anëtarë të tjerë nga Prokuroria e



Apelit). Asnjëri nga ta nuk ishin anëtar të KPK-së. Nga katër kandidatët që ishin pjesë e procesit të përzgjedhjes, dy prej tyre u propozuan nga Komisioni Vlerësues për t'u votuar për kryeprokuror të PSRK-së. Të dy kandidatët që nuk ishin rekomanduar janë ankuar në KPK në vendimin e Komisionit Vlerësues. KPK ka miratuar pjesërisht ankesat e kandidatëve", është thënë në këtë komunikatë.

IKD-ja ka vlerësuar se për këtë konkurs të zgjedhjes së kryeprokurorit të PSRK-së, KPK-ja ka tentuar ta ndjekë praktikën e kundërligjshme të krijuar nga KGJK-ja për t'i ndërruar rregullat në mes të procesit, për të cilën kishte reaguar IKD-ja publikisht. "KPK në mbledhjen e saj më 25 prill 2019, në agjendën e ditës, edhe pse në mes të procesit për kryeprokuror të PSRK-së kishte paraparë ndryshimin e Rregullores për Zgjedhjen dhe Emërimin e Kryeprokurorëve, e cila edhe ashtu ishte ndryshuar para dy muajve, përkatësisht më 21 shkurt 2019. Tendencë që rrugës të ndryshohen rregullat, dëshmon se ka pasur agjendë për t'i përshtatur rregullat dhe procedurat për kandidatë të

caktuar nga ana e KPK-së, duke u thirrur se 'ndryshimet në rregulloret duhet të bëhen për t'u harmonizuar me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese në lidhje me procesin e kryeprokurorit të Shtetit'. Sidoqoftë, në mbledhjen e KPK-së, të mbajtur më 25 prill 2019, anëtarët e KPK-së, përkundër përfshirjes së kësaj pike në agjendën e ditës, kanë theksuar se ndryshimi i rregullores në mes të procesit përbën shkelje ligjore. Në këtë situatë, KPK më 25 prill 2019 ka vendosur ta kthejë procesin e zgjedhjes së kryeprokurorit të PSRK-së, në pikën zero, duke anuluar konkursin dhe duke autorizuar Komisionin për Çështje Normative që të hartojë një Rregullore për Emërimin e Kryeprokurorëve sa më parë të jetë e mundur, bazuar në ndryshimet ligjore dhe në aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese", është theksuar në komunikatën e IKD-së.

Më tej thuhet se sfidat kryesore të KPK-së në vitet e fundit janë në lidhje me procesin e rekrutimit dhe emërimit të kryeprokurorëve, prokurorëve lidhen me miratimin dhe ndryshimin e shpeshtë të legjislacionit sekondar dhe moszba-

timin e tij në praktikë. "Përveç kësaj, edhe pse kriteret për rekrutimin dhe emërimin e prokurorëve sigurohen me ligj, KPK-ja përmes legjislacionit sekondar shpesh kanë ndryshuar rregullat dhe kriteret gjatë procesit të emërimit, që dëshmon mungesën e aftësisë së KPK-së në bërjen e politikave të qarta dhe transparente dhe zbatimin e tyre në praktikë që ende çalon. KPK-ja duhet të fokusohet në hartimin dhe miratimin e rregullores së re për emërimin e kryeprokurorit të Shtetit dhe kryeprokurorëve në të cilin do ta përcaktojë qartë procedurën për përzgjedhjen dhe emërimin, duke përfshirë sigurimin e rregullave dhe kriterëve të qarta, transparente dhe objektive. Kjo mundëson që sistemi prokurorial t'i arrijë objektivat dhe KPK t'i kryejë funksionet e veta, pasi është thelbësore që kryeprokurorët në të gjitha nivelet të zgjedhen në bazë të kompetencave të dëshmuara, integritetit dhe pavarësisë, si dhe në përputhje me procedurat e paanshme, duke përjashtuar çdo diskriminim dhe duke lejuar mundësinë e rishikimit të paanshëm", thuhet në komunikatën e IKD-së.

IKD-ja rekomandon që përmes miratimit të Rregullores së re, KPK-ja duhet t'i arrijë këto objektiva që: procesi i emërimit të udhëhiqet nga KPK-ja, duke shmangur praktikën që një detyrë e tillë e rëndësishme të delegohet në komisionet e vlerësimit; hartimi i Rregullores duhet të bëhet në konsultim të mbyllur me OJQ-të e interesuara të specializuara në sundimin e ligjit, Odën e Avokatëve dhe akademikët; procesi i emërimit të kryeprokurorëve duhet të bazohet në rregulla, kriteret objektive, të qarta dhe transparente; procesi i emërimit duhet të jetë i hapur për shqyrtim publik dhe të dokumentohet plotësisht dhe siç duhet si dhe duhet të ndërmerret sipas kriterëve të publikuara dhe jo që ato të ndryshohen në mënyrë të kundërligjshme gjatë procesit; emërimi duhet të bazohet vetëm në merita, duke promovuar diversitetin dhe duke shmangur diskriminimin; procesi i emërimit duhet të sigurojë një procedurë të pavarur të ankesave; dhe procedurat për emërimin duhet të karakterizohen nga një shkallë e lartë publiciteti dhe transparence për publikun.

Instituti Hidrometeorologjik paralajmëron vërshime të martën

PRISHTINE, 12 MAJ (ER) - Sektori i Hidrologjisë i Institutit Hidrometeorologjik të Kosovës (IHMK) ka parashikuar se do të ndodhin vërshime për shkak të reshurave të mëdha që do ta përfshijnë vendin në ditët në

vijim. Sipas njoftimit të IHMK-së, vërshimet do të paraqiten më 14. 5. 2019 dhe do ta përfshijnë pjesën perëndimore, jugore dhe veriore të Kosovës. "Parashikohet që reshjet të jenë të pandërprera për 72 orë me një sasi prej 30 - 50

mm dhe me probabilitet të lartë të reshjeve ekstreme, përmytjeve dhe rrëshqitjeve të dheut në zonat e ndjeshme. IHMK-ja ka njoftuar se zonat më të goditura do të jenë pjesa perëndimore dhe jugore e vendit.



'Demokracia në veprim' përcjell procesin zgjedhor në veri me mbi 100 vëzhgues

Në ditën e zgjedhjeve, më 19 maj, "Demokracia në veprim" do të ketë vëzhgues në secilin prej 87 vendvotimeve që pritet të hapen në territorin e katër komunave të veriut të Kosovës.

"Demokracia në veprim" do të angazhojë mbi 100 vëzhgues si dhe do të ketë ekipe mobile të cilat do ta përcjellin në përgjithësi mbarëvajtjen e procesit zgjedhor

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 12 MAJ - Koalicioni i OJQ-ve vendore për vëzhgimin e zgjedhjeve "Demokracia në veprim", përmes partnerit të saj në Mitrovicë e Veriut, Advocacy Center for Democratic Culture (ACDC), do të jetë e angazhuar në misionin vëzhgues për zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetarë të komunave Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zvečan, që do të mbahen më 19 maj. Me këtë rast, Ismet Kryeziu nga "Demokracia në veprim" ka riafirmuar përkushtimin e DnV-së për ta siguruar integritetin e zgjedhjeve, për të promovuar fushatë të qetë zgjedhore dhe për ta informuar publikun në mënyrë të drejtë për ecurinë e procesit. "Misioni ynë do të kontribuojë në rritjen e transparencës, besueshmërisë dhe gjithëpërfshirjes në procesin zgjedhor përmes vlerësimit tonë të paanshëm dhe objektiv", ka thënë ai.

Lidhur me planin operacional të vëzhgimit, Srdjan Milojeviq nga ACDC-ja ka bërë me dije se gjith-

sej 116 vëzhgues do të përfshihen në vëzhgimin e periudhës para, gjatë dhe pas ditës së zgjedhjeve. Nëpërmjet vëzhguesve afatgjatë, DnV-ja do ta bëjë vëzhgimin e të gjitha aktiviteteve të fushatës parazgjedhore e cila do të fillojë sot (e hënë) dhe do të zgjasë deri më 17 maj.

Në ditën e zgjedhjeve, DnV-ja do të ketë vëzhgues në secilin prej 87 vendvotimeve që pritet të hapen në territorin e katër komunave të veriut të Kosovës.

Për më shumë, "Demokracia në Veprim" do të angazhojë edhe ekipe mobile të cilat do ta përcjellin në përgjithësi mbarëvajtjen e procesit zgjedhor. Pas përfundimit të procesit zgjedhor, DnV-ja do të përgatisë edhe një raport vlerësues të zgjedhjeve bazuar në të dhënat e vëzhguesve tanë, në linjë me kornizën ligjore të Kosovës dhe parimet ndërkombëtare të zgjedhjeve.

Në prag të fillimit të fushatës zgjedhore, "Demokracia në veprim" ka ftuar të gjitha subjektet politike të përfshira në proces që të zhvillojnë një garë fer dhe të lirë zgjedhore. Po ashtu, DnV-ja u ka bërë thirrje qytetarëve me të



drejtë vote që të përfshihen në aktivitetet e fushatës parazgjedhore, në mënyrë që të jenë sa më të informuar për premtimet dhe programet e kandidatëve për kryetarë të komunave.

Gjatë fushatës parazgjedhore DnV-ja në vazhdimësi do ta informojë publikun lidhur me mbarëvajtjen e fushatës parazgjedhore përmes raporteve ditore dhe konferencave për shtyp që do të mbahen në Mitrovicë e Veriut, përkatësisht në zyrat e organizatës partnere ACDC.

DnV-ja mban trajnimin e parë vëzhguesit për zgjedhjet në veri

"Demokracia në veprim" ka mbajtur të dielën trajnimin e parë për vëzhguesit afatgjatë (LTO) të zgjedhjeve të jashtëzakonshme për kryetarë të komunave Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zvečan. Në këtë trajnim janë prezantuar standardet kryesore të monitorimit të fushatës parazgjedhore, përgjegjësitë që do t'i kenë monitoruesit e fushatës parazgjedhore si dhe format e raportimit.

Sot fillon fushata zgjedhore për zgjedhjet lokale në veri

EPOKA E RE **F. DËRMAKU**

PRISHTINË, 12 MAJ - Zëdhënësi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Valmir Elezi, ka bërë me dije se sot (e hënë) do të fillojë fushata pesëditore për zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar në komunat: Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zvečan dhe Zubin Potok. Ai ka treguar se gjatë kësaj periudhe subjektet politike kanë të drejtë të organizojnë tubime apo ngjarje politike, ose aktivitete të tjera të ngjashme, përmes të cilave synojnë përkrahjen e votuesve. "Pra, janë pesë ditë në dispozicion të subjekteve politike dhe kandidatëve të tyre për të bërë fushatë zgjedhore", ka deklaruar Elezi.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i ka ftuar subjektet politike, kandidatët dhe mbështetësit e tyre, që t'u përmbahen ligjeve të Republikës së Kosovës dhe rregullave zgjedhore. Elezi ka theksuar

se vetëm në këtë mënyrë do t'i kontribuojnë një procesi zgjedhor të rregullt të pranuar. "Pa dyshim se subjektet politike, kandidatët dhe mbështetësit e tyre, kanë rolin kryesor në proces zgjedhor të qetë, të lirë dhe demokratik. Prandaj, ne bëjmë thirrje që kjo të arrihet", është shprehur Elezi.

Fushata zgjedhore përfundon të premten, ndërsa procesi zgjedhor do të zhvillohet më 19 maj. Në mbledhjen e fundit që ka pasur KQZ-ja ka miratuar sloganin për zgjedhjet që do të mbahen në këto katër komuna: "Vota juaj. Ardhmëria juaj".

Zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar në komunat Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zvečan do të mbahen më 19 maj. Katër kryetarët e këtyre komunave më 27 nëntor të vitit 2018 kanë dhënë dorëheqje, duke kundërshtuar vendimin e Qeverisë së Kosovës për vendosjen e taksës 100 për qind ndaj prodhimeve të importuara nga Serbia.



Efektet ekonomike të taksës ndaj produkteve të Serbisë dhe Bosnjës e Hercegovinës

Taksa 100 për qind ka ndikuar në rritjen e çmimeve

Instituti GAP ka publikuar të dielën raportin "Taksa 100 për qind: a po e ndihmon apo dëmton ekonominë e Kosovës?" Të gjeturat e raportit tregojnë se brenda pesë muajve që nga vendosja e taksës 100 për qind importet nga Serbia shënuan rënie prej 88 përqindësh (160 milionë euro), kurse importet nga Bosnja dhe Hercegovina u zvogëluan për 83 për qind (24 milionë euro). Përfituesit më të mëdhenj gjatë kësaj periudhe ishin Sllovenia, Izraeli dhe Turqia të cilat patën ngritje të madhe të eksportit në Kosovë



EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 12 MAJ - Instituti GAP ka organizuar të dielën konferencë për media, ku ka publikuar raportin "Taksa 100 për qind: a po e ndihmon apo dëmton ekonominë e Kosovës?".

Ky raport prezanton një vlerësim të efekteve të taksës në prodhimet vendore, çmimet e ushqimit dhe tregtinë me vendet e tjera. Të gjeturat e raportit tregojnë se brenda pesë muajve që nga vendosja e taksës 100 për qind, importet nga Serbia shënuan një rënie prej 88 përqindësh (160 milionë euro), kurse importet nga Bosnja dhe Hercegovina u zvogëluan për 83 për qind (24 milionë euro). Përfituesit më të mëdhenj gjatë kësaj periudhe ishin Sllovenia, Izraeli dhe Turqia të cilat patën ngritje të madhe të eksportit në Kosovë.

Përkundër rënies së importit nga

Serbia dhe Bosnja, deficitit tregtar i Kosovës është rritur. Kjo nënkupton se prodhuesit vendorë nuk kanë arritur t'i shfrytëzojnë mundësitë e taksës siç është menduar. Të dhënat nuk tregojnë për ndonjë rritje të përshpejtuar të industrisë përpunuese në Kosovë, qoftë sa i përket vëllimit të prodhimit apo gjenerimit të vendeve të reja të punës. "Në anën tjetër, taksa 100 për qind duket të ketë ndikuar në përshpejtimin e rritjes së çmimeve të konsumit në ushqim të cilat përbëjnë shpenzimin kryesor të shportës së konsumatorëve kosovarë. Ndër arsytet që mund të kenë ndikuar në rritjen e çmimeve të produkteve ushqimore janë: ulja e konkurrencës në produkte të caktuara, rritja e kostos së lëndës së parë për bizneset vendore dhe rritja e kostos së transportit dhe çmimeve të produkteve të importuara. Në mungesë të produkteve zëvendësuese, për disa prodhime koso-

vare janë rritur çmimet me hyrjen në fuqi të taksës 100 për qind. Duke marrë parasysh këtë, mbajtja e kësaj takse për një kohë më të gjatë mund të ketë efekte në rritjen e varfërisë", është theksuar në raportin "Taksa 100 për qind: a po e ndihmon apo dëmton ekonominë e Kosovës?"

Duke qenë se Kosova dhe Serbia janë nënshkruese të Marrëveshjes për Tregti të Lirë për Evropën Qendrore (CEFTA)

dhe kanë detyrime që t'i anulojnë tarifatat tregtare, dhe duke pasur parasysh se zotimi për zbatimin e CEFTA-s është futur edhe në Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit të nënshkruar në mes të Kosovës dhe Bashkimit Evropian, Instituti GAP rekomandon si mundësi më të mirë për Kosovën rinegocimin e CEFTA-s së bashku me vendet e tjera anëtare.

Berat Thaqi nga Instituti GAP ka thënë se në dy muajt e fundit kanë analizuar efektet ekonomike nga taksa, ku nuk kanë vërejtur rritje të ekonomisë së vendit. "Kjo taksë e vendosur në nëntor nuk është hartuar mirë. Nuk kemi parë ndonjë përfitim të vendit. Ne e kemi shikuar edhe atë se a rrezikohet marrëveshja e CEFTA-s dhe a ka mundësi Serbia ta padisë Kosovën. Kosova nuk e ka shkelur marrëveshjen e CEFTA-s, sepse Serbia me themelimin e ushtrisë e ka kërcënuar Kosovën me luftë. Taksa nuk e ka ndihmuar rritjen e prodhimit vendor. Tek çmimet e prodhimeve e konsumit dhe pijeve kemi pasur rritje të shpejtuar. Me hyrjen në fuqi të taksës, shumë biznese i kanë rritur çmimet", ka thënë ai.

Ndërkaq Blend Hyseni ka theksuar se shumica e kontrabandës me produktet nga vendet për të cilat është vendosur tarifa, po bëhet përmes vendeve të rajonit. "Importi i përgjithshëm ka vazhduar të rritet. Vazhdojnë dyshimet se prodhimet e Bosnjës dhe Serbisë po vazhdojnë të hyjnë në Kosovë përmes vendeve rajonale. Nuk ka pasur një efekt në eksporte", ka thënë Hyseni.

Që nga viti 2008 kur Kosova ka shpallur pavarësinë, Kosova dhe Serbia kanë pasur marrëdhënie të tensionuar tregtare dhe politike. Me gjithë rregullimin e çështjeve të menaxhimit të kufirit dhe anulimin e tarifave tregtare, tregtia në mes të Kosovës dhe Serbisë vazhdon të pengohet nga barrierat jotarifore dhe tensionet politike. Me nënshkrimin e CEFTA-s, Kosova ka hyrë në obligime për anulimin e tarifave tregtare, mirëpo për shkak të kërcënimit me luftë nga ana e Serbisë ndaj Kosovës, marrëveshja nuk e ndalon Kosovën që të marrë çfarëdo masa për mbrojtjen e interesit kombëtar, përfshirë edhe vendosjen e tarifave të reja. Që nga vendosja e masës mbrojtëse (nëntor 2018 - mars 2019), importet nga Serbia dhe BiH shënuan rënie drastike. Përkundër rënies së importit nga këto dy vende, deficitit tregtar i Kosovës është rritur. Të dhënat e Doganës tregojnë se pothuajse vlera e njëjtë e produkteve të importuara nga Serbia dhe BiH vazhdojnë të importohen nga vende të tjera, duke mos lënë shumë hapësirë për zëvendësimin e importit nga prodhuesit vendorë. Të dhënat nuk tregojnë për ndonjë rritje të përshpejtuar të industrisë përpunuese në Kosovë qoftë sa i përket vëllimit të prodhimit apo gjenerimit të vendeve të reja të punës. Të gjitha këto lënë për të kuptuar se prodhuesit vendorë nuk kanë arritur t'i shfrytëzojnë mundësitë e taksës siç është pararenduar. Ndërkaq përfituesit më të mëdhenj tregtar gjatë kësaj periudhe duket të jenë shtetet si Sllovenia, Izraeli dhe Turqia.



Deficiti tregtar shënon ulje për 2.1 për qind

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), lidhur me rrjedhat e eksportit dhe importit për muajin janar 2019, të dhënat nga Tregtia e Jashtme në Kosovë tregojnë për një deficit tregtar më të ulët për 2.1 për qind në muajin janar 2019 në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2018, gjegjësisht në vlerë prej 166.9 milionë eurosh, krahasuar me deficitin prej 170.5 milionë eurosh në vitin 2018



EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 12 MAJ - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar të dhënat e Tregtisë së Jashtme lidhur me rrjedhat e eksportit dhe importit për muajin janar të këtij viti. Sipas ASK-së, të dhënat nga Tregtia e Jashtme në Kosovë tregojnë për një deficit tregtar më të ulët për 2.1 për qind në muajin janar të këtij viti në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2018, gjegjësisht në vlerë prej 166.9 milionë eurosh krahasuar me deficitin prej 170.5 milionë eurosh në vitin 2018. "Eksporti mbulon importin me 12.3 për qind. Eksporti i mallrave në muajin janar 2019 kishte vlerën 23.4 milionë euro, ndërsa importi kishte vlerën prej 190.4 milionë eurosh, ku është një rënie prej (-4.3 përqindësh) për eksport, si dhe një rënie prej (-2.4 përqindësh) për import, duke krahasuar me periudhën e njëjtë

të vitit 2018", është thënë në raportin e ASK-së.

Sipas të dhënave të grupeve kryesore të eksportit: 36.8 për qind të eksporteve e përbëjnë metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 13.2 për qind e përbëjnë plastika, goma dhe artikujt prej tyre; 12.2 për qind e përbëjnë produktet minerale; 7.1 për qind e përbëjnë makineritë, pajisjet mekanike dhe elektrike; 6.1 për qind e përbëjnë artikujt e ndryshëm të prodhuar; 5.4 për qind e përbëjnë ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 4.9 për qind e përbëjnë produktet bimore etj. "Ndërsa, sipas të dhënave të grupeve kryesore për import e përbëjnë: 18.1 për qind produktet minerale; 11.8 për qind ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 11.4 për qind makineritë, pajisjet mekanike dhe elektrike; 8.5 për qind metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 8.5 për qind mjetet e transportit; 7.9 për qind produktet e indus-

trisë kimike; 5.5 për qind plastika, goma dhe artikujt prej tyre etj", thuhet në publikimin e ASK-së.

Sipas ASK-së, eksportet e Kosovës në vendet e BE-së arritën në 8.9 milionë euro, ose rreth 38 për qind e eksporteve të përgjithshme, me një rritje prej 40.8 përqindësh. "Partnerët kryesorë për eksportin e mallrave në BE janë: Gjermania (9.3 për qind), Italia (8.5 për qind), Holanda (5.2 për qind), Britani e Madhe (3.9 për qind). Importet e Kosovës nga vendet e BE-së ishin rreth 99.2 milionë euro, ose 52.1 për qind e importeve të përgjithshme, me një rritje prej 55.5 përqindësh. Importet me pjesëmarrje më të

lartë ishin nga: Gjermania (11.7 për qind), Sllovenia (7.3 për qind), Greqia (6.2 për qind), Italia (4.8 për qind), Bullgaria (4.3 për qind) etj. Në muajin janar 2019, eksportet e Kosovës me vendet e CEFTA-s arritën në 7.4 milionë euro, ose 31.9 për qind të eksporteve të përgjithshme, me një rënie prej (-22.8 përqindësh). Partnerë kryesorë për eksport nga vendet e CEFTA-s janë: Shqipëria (10.9 për qind), Maqedonia (8.7 për qind), Serbia (6.1 për qind), Mali i Zi (4.9 për qind)", thuhet në këtë raport.

Ndërsa importet nga vendet e CEFTA-s në muajin janar 2018 arritën në 19.8 milionë euro, ose 10.4 për qind të importeve të

përgjithshme, me një rënie prej (-46.5 përqindësh). Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import ishin: Maqedonia (5.7 për qind), Shqipëria (3.6 për qind) dhe Serbia (0.4 për qind). "Eksportet e Kosovës me vendet e tjera të botës arritën në 7 milionë euro, ose 30.1 për qind. Si partnerë më të rëndësishëm nga këto vende për eksport vlen të përmenden: India (14.9 për qind), Zvicra (9.0 për qind). Ndërsa, importet e Kosovës me vendet e tjera të botës arritën në 71.3 milionë euro, ose 37.5 për qind. Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import në këtë grup ishin: Kina (10.9 për qind) dhe Turqia (10.4 për qind)", është thënë në raportin e ASK-së.

LV-ja: 'PANqeveria' po merr borxh për të paguar borxhe të tjera

PRISHTINË, 12 MAJ (ER) - Lëvizja Vetëvendosje ka akuzuar Qeverinë e Kosovës se është duke marrë borxh për t'i paguar pagat e atyre që janë punësuar me nepotizëm dhe pa meritë në sektorin publik. Sipas kësaj lëvizje, Qeveria Haradinaj është skajshmërisht e korruptuar dhe merr para borxh në emër të Kosovës për t'i keqpërdorur ato. "Borxhi mund të jetë një mjet për ta ndihmuar zhvillimin dhe rritjen e ekonomisë së Kosovës, nëse përdoret me përgjegjësi dhe mençuri. Por një qeveri skajshmërisht e korruptuar merr para borxh në emër të Kosovës dhe i keqpërdor ato. Një borxh i cili nuk përdoret për ta zhvilluar ekonominë,

rezikon ta shkatërrojë atë", është thënë në reagimin e Vetëvendosjes. Në këtë reagim është thënë se qeveria është duke marrë borxh për të paguar borxh. "PANqeveria" po merr borxh për të paguar borxhe të tjera, po merr borxh për asfalt sepse aty mund të vjedhë shpejt e shumë, dhe po merr borxh për t'i paguar pagat e atyre që janë punësuar me nepotizëm dhe pa meritë në sektorin publik. Ka ardhur koha që 'PANqeveria' të largohet dhe 'PANhajnia' të ndalet. Kosovën e fituam me luftë e sakrificë, nuk do të lejojmë ta humbim me borxhe e kamata", është theksuar në reagimin e Lëvizjes Vetëvendosje.



**Kundër
PANhajnisë**



BORXHI I JASHTËM Në më pak se një dekadë borxhi i jashtëm kaloi **1 miliardë €.**

Në më pak se dy vite qeverisje me PAN-in, dhe kryeministrin Ramush Haradinaj, borxhi i Kosovës u rrit në **1 miliardë e 418 milionë €.**

Me PAN-in, dhe kryeministrin Haradinaj

- borxhi** i brendshëm që në fund të 2018 ishte **676 milionë €**, në vitin 2019 arriti në **815 milionë €.**
- borxhi** i jashtëm që në fund të 2018 ishte **416 milionë €**, në vitin 2019 u rrit në **559 milionë €.**
- borxhi** i Kosovës shënoi shifra rekorde, **tre fishin e vitit 2013**, kur borxhi ishte vetëm **476 milionë €.**

Borxhi po rritet, bashkë me hajninë

Komuna e Prizrenit fillon vendosjen e pengesave në rrugë për siguri në trafik

PRIZREN, 12 MAJ (ER) - Komuna e Prizrenit ka njoftuar se ka filluar vendosjen e pengesave në rrugë me qëllim të ngritjes së sigurisë në trafik. "Me qëllim të ngritjes së sigurisë në trafik, sidomos në ato pjesë ku ka fluks më të madh

të qarkullimit të këmbësorëve, Komuna e Prizrenit këto ditë ka filluar punimet për vendosjen e pengesave në rrugë për ngadalësimin e shpejtësisë së makinave si dhe zëvendësimin e pengesave të dëmtuara me ato

të reja. Punimet aktuale janë duke u kryer në unazën kryesore të qytetit, ku me këtë synohet edhe zvogëlimi i numrit të aksidenteve në trafik", ka njoftuar Komuna e Prizrenit, e cila drejtohet nga Mytahir Haskuka.



Ferizaj përkujton dëshmorët Njazi Bajraktari dhe Faton Vehbiu

FERIZAJ, 12 MAJ (ER) - Në 20-vjetorin e rënies janë përkujtuar dëshmorët e kombit, Njazi Bajraktari dhe Faton Vehbiu. Kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Ferizajt, Kristina Gashi-Bytyçi, bashkë me drejtorë komunalë, kryetarin e Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve, Gafurr Bytyçi, atë

të Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së në Ferizaj, Rafiz Sejdiu, dhe dhjetëra qytetarë e familjarë të dëshmorëve, kanë bërë homazhe duke u përkulur dhe vendosur kurora me lule në varret e dy dëshmorëve dhe lapidarin e dëshmorëve të UÇK-së në Kompleksin e Varrezave të

Dëshmorëve të Kombit në Ferizaj.

Dëshmorët e Kombit, Njazi Bajraktari dhe Faton Vehbiu, kanë rënë heroikisht për të mos vdekur kurrë, 20 vjet më parë, në luftën çlirimtare sikurse mijëra dëshmorë të tjerë, vepra, heroizmi, sakrificat e të cilëve ka sjellë lirinë dhe pavarësinë e Kosovës.

Në 21-vjetorin e rënies përkujtohet heroji Agron Rrahmani

PRISHTINË, 12 MAJ (ER) - Kryetari i Lëvizjes për Bashkim (LB), Valon Murati, me bashkëpunëtorë kanë përkujtuar heroin e kombit, Agron Rrahmani-Naseri, i cili ka rënë heroikisht në vitin 1998. Me këtë rast, Murati ka thënë se Agron Rrahmani tërë jetën ia ka kushtuar atdheut. "Agroni tërë jetën ia kushtoi çështjes së lirisë dhe atdheut në rrugën e luftës çlirimtare. Këtë përkushtim e pat në kohën më të vështirë për atdheun, kur të paktët ishin në

atë rrugë. Aktivist i orëve të para, anëtar i udhëheqës në LKÇK, komandant i njësisë së parë guerile të LKÇK-së, organizator i njësisë të UÇK-së që bartën peshë në luftën tonë çlirimtare. Sa vështirë ishte të ishte si ti dje e sa lehtë të të nderojmë sot pranë varrit. Po nderimi më i madh do të ishte nëse ne sot vazhdojmë ta duam vendin ashtu siç e deshe ti. Nderim i përjetshëm për ty shok i dashur", ka thënë Murati.



Nisin punimet për vendosjen e shtatores së Luan Haradinajt në Pejë

DEÇAN, 12 MAJ (ER) - Kryetari i Komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, ka bërë me dije se të dielën kanë filluar punimet për vendosjen e shtatores së heroit të kombit Shkëlzen Haradinaj dhe ndërtimit të monumentit kushtuar 183 heronjve dhe

dëshmorëve nga Peja. Ai ka thënë se ky investim është duke u përkrahur nga Komuna e Pejës dhe bashkëluftëtarët e Luanit dhe dëshmorëve të tjerë. "Sot filluan punimet për vendosjen e shtatores së heroit të kombit Shkëlzen Haradinaj, po ashtu

ndërtimi i monumentit kushtuar 183 heronjve dhe dëshmorëve të kombit nga Peja. Investim nga bashkëluftëtarët, përkrahur nga Komuna e Pejës. Lavdi të rënëve për atdhe!", ka shkruar Ramosaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Rregullohet ura në Korenicë të Gjakovës

GJAKOVË, 12 MAJ (ER) - Ura në Korenicë të Komunës së Gjakovës tashmë ka marrë pamje të re. Ministri i Infrastrukturës dhe Transportit, Pal Lekaj, ka bërë

me dije se si për rregullimin e kësaj ure, në të cilën ka investuar Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit, njëjtë do të vepronjë edhe në urat ku është i nevojshëm intervenimi.

"Njëjtë do të veprojmë në të gjitha urat e Republikës së Kosovës që janë në kompetencë të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit", ka thënë Lekaj.



Dick Marty është shëndosh e mirë sa herë duhet të shpifë kundër shqiptarëve

- Dick Marty është shëndosh e mirë sa herë duhet të shpifë kundër shqiptarëve, ndërsa kur duhet të ballafaqohet me të vërtetën ai paraqitet "i sëmurë"!

Shkruan: Bardhyl MAHMUTI

Në kohën kur Kuvendi i Kosovës është në prag të miratimit të një rezolute për gjenocidin serb në Kosovë, kur kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka aktualizuar domosdoshmërinë e ndëshkimit të atyre që kanë kryer krime gjatë luftës në Kosovë dhe dëshmitë të Vasfije Krasniqit para Kongresit Amerikan për dhunën seksuale dhe tmerrin e përjetuar gjatë luftës, propaganda serbe është lëshuar në një fushatë të egër me qëllim që ta zhvendosë vëmendjen e opinionit publik në sajat e saj.

Në funksion të kësaj strategjie propaganda serbe përsëritë shpifjet për gjoja "trafikimin e organeve njerëzore nga ana e UÇK-së" dhe fton në "ndihmë" edhe ata "që kanë marrë shpërblime dhe mirënjohje në Zvicër dhe në botë". Siç njoftojnë mediat, Dick Marty paska paralajmëron "dëshmi" të reja për krimet e luftës në Kosovë. Opinionit publik shqiptar i kujtohet fakti që në Lozanë të Zvicrës, më 31 tetor 2018, Dick

Marty bëri përrurimin e librit të titulluar "Une certaine idée de la justice- Tchétchénie-CIA-Kosovo-drogue" (Njëfarë ideje për drejtësinë - Çeçenia, CIA - K o s o v a - d r o g a). Shfrytëzova rastin t'i jepja librin tim dhe t'i kërkoja ballafaqim lidhur me të pavërtetat që përhapin shkrimet e tij për shqiptarët në përgjithësi dhe luftën e UÇK-së në veçanti. Ai e pranoi ftesën time dhe deklaroi publikisht, në praninë e personaliteteve që kishin ardhur për përrurimin e librit të tij, se do të ballafaqohet me mua sapo ta ketë lexuar librin tim. Pasi kaluan më shumë se pesë muaj nga takimi në Librarianë "Payot" të Lozanës, vendosa t'i shkruaj për t'i kërkuar përgjigje lidhur me premtimin e dhënë. Në përgjigjen e tij të datës 10 prill Dick Marty më shkroi: "Ende nuk e kam lexuar librin tuaj, thjesht për arsye se kam qenë i sëmurë dhe nuk kam pasur ende kohë". Është fakt që Dick Marty ka pohuar publikisht se ka qenë i sëmurë para se t'i qasej shkrimit dhe publikimit të librit "Une certaine idée de la justice- Tchétchénie-CIA-Kosovo-



drogue" (Njëfarë ideje për drejtësinë - Çeçenia, CIA-Kosova-droga), mirëpo, gjithashtu, është fakt i pamohueshëm se, siç e ka thënë në disa prezantime publike, ai ndihet shumë mirë. Madje

gjendjen e shkëlqyer e ka dëshmuar duke qenë i pranishëm në përrurimin e librit të tij në shumë qytete të Zvicrës dhe në intervista televizive. Nuk u mjaftua me përrurimin e librit në Zvicër, por shkroi në shoqërim

të delegacionit të Serbisë në Këshillin e Evropës në Strasburg dhe, pos të tjerash, edhe atje e bëri përrurimin e librit. Madje ai është shëndosh e mirë sa herë duhet të shpifë kundër shqiptarëve.

Po e përsëris atë që i kam shkruar Dick Martyt: Ikja nga ballafaqimi nuk është karakteristike e atyre personaliteteve që pretendojnë se janë burra të fjalës dhe që shesin moral. Sa më përket mua, e lë të hapur mundësinë e ballafaqimit me cilindo qoftë që ka shpifur rreth luftës çlirimtare të popullit shqiptar. Madje nëse do të ndihej më i sigurt, Dick Marty mund të vijë në debat së bashku me ish-ambasadorin e Serbisë në Zvicër, Milan St. Protiqin dhe pjesëtarë të Shërbimit Sekret të Serbisë të cilët redaktuan raportin për, gjoja, "trajtimin çnjerëzor të personave dhe tregtinë ilegale me organet e njerëzve në Kosovë".

P.S.
Gazeta "Vecernje Novosti" e datës 11 maj njofton se "hetimi që ka zhvilluar Dick Marty, hetim dinjitoz për romanin më të mirë të spiunazhit, zuri faqet e para të shtypit botëror". Libri im "Mashtrimi i madh", që zhvesh në tërësi raportin e përpiluar nga Shërbimi Sekret i Serbisë dhe i shpërndarë në emër të Dick Martyt, zuri vend në depot e institucioneve të Kosovës!

Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit: Do të merren masa ligjore për ata që e vrasin ariun

PRISHTINË, 12 MAJ (ER) - Pas publikimit të informacionit për vendimin e Agjencisë së Pyjeve të Kosovës për vrasjen e ariut të murrmë, Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit në Kosovë (AMMK) ka njoftuar opinionin publik që ky vendim është në kundërshtim me rekomandimet dhe qëndrimet e komisionit profesional të MMPH-së që ishte ngritur për vlerësimin e kësaj gjendje. Komisioni për vlerësimin e masave që duhet të ndërmerren për mbrojtjen e banorëve dhe pasurisë së tyre të shkaktuara nga ariu i murrmë ka përfunduar punën e vet lidhur me vlerësimin e situatës dhe dhënien e rekomandimeve për masat që duhet të ndërmerren lidhur me këtë situatë. "Komisioni ka hartuar një raport ku janë prezantuar edhe

këto rekomandime dhe masa të sigurisë. Mes të tjerash, është rekomanduar që të shtohen masat e sigurisë, të ndërrohet habitat i ariut, të zbatohet legjislacioni në fuqi për llojet e mbrojtura shtazore si dhe të hartohet plani i veprimit për menaxhimin e situatës. MMPH/AMMK paralajmëron se do të merren masa ligjore për të gjithë ata që veprojnë në kundërshtim me legjislacionin për llojet e mbrojtura shtazore, përfshirë edhe ngritjen e padive ndaj atyre që vrasin ariun", është thënë në reagimin e AMMK-së.



Përfundon trajnimi dyjavor i zyrtarëve korrektues

PRISHTINË, 12 MAJ (ER) - Në Qendrën Ndërkombëtare të Trajnimeve ICMTC në Canon City-Colorado të ShBA-së, grupi i deleguar nga Shërbimi Korrektues i Kosovës (ShKK) ka përfunduar trajnimin dyjavor me temën "Inteligjenca e burgjeve". Ky trajnim u mbajt si

rezultat i marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet ShKK-së dhe International Narcotics and Law (INL-së) për trajnimin e stafit korrektues dhe ka për qëllim avancimin dhe profesionalizimin e stafit të Shërbimit Korrektues të Kosovës në ngritjen e kapaciteteve profesionale.

Shërbimi Korrektues i Kosovës është çdoherë falënderues ndaj ShBA-së, ICMTC-së, për përkrahjen e vazhdueshme dhe ndihmën që ka dhënë dhe po vazhdon të japë në profesionalizimin më modern të kapaciteteve të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Netanyahu kërkon afat shtesë për formimin e qeverisë

Tel-Aviv, 12 maj - Kryeministri i Izraelit, Benjamin Netanyahu, deklaroi të dielën se do t'i kërkonte presidentit Reuven Rivlin një afat shtesë për formimin e qeverisë së re të koalicionit, me arsyetimin e festave të fundit dhe përshkallëzimin e situatës në Gaza. Likoud (e djathta) e Netanyahu

fitoi 35 vende nga 120 në zgjedhjet e përgjithshme të 9 prillit. Shumica e krerëve të partive i rekomanduan Rivlin për të përzgjedhur kryeministrin në ikje për formimin e koalicionit të ardhshëm qeverisës.

Më 17 prill, Rivlin i besoi zyrtarisht këtë mision Netanyahu, i cili

sipas ligjit ka në dispozicion një afat 28 ditor, por një afat shtesë me 14 ditë jepet automatikisht sipas kërkesës. "Ashtu si në të kaluarën, unë do t'i parashtoj presidentit një kërkesë për zgjatjen e afatit", deklaroi Benjamin Netanyahu përpara nisjes së mbledhjes javore të këshillit të ministrave.



Pompeo në Moskë, takon presidentin Putin dhe ministrin Lavrov

Sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo, nesër (e martë) në Soçi do të bisedojë me presidentin rus Vladimir Putin dhe ministrin e Jashtëm, Sergei Lavrov, në një atmosferë marrëdhëniesh të acaruar mes dy vendeve për një numër temash, duke përfshirë Venezuelën, Iranin dhe ndërhyrjet ruse në zgjedhjet e 2016-s

WASHINGTON, 12 MAJ - Sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo, do të takohet me presidentin e Rusisë, Vladimir Putin dhe ministrin e Jashtëm rus, Sergei Lavrov, gjatë kësaj jave, në një atmosferë marrëdhëniesh të acaruar mes dy vendeve për një numër temash duke përfshirë Venezuelën, Iranin dhe ndërhyrjet ruse në zgjedhjet e 2016-s. Sekretari i Shtetit është nisur të dielën për në Moskë për vizitën e tij të parë në Rusi si shef i diplomacisë amerikane. Zyrtarë të lartë amerikanë, ndër ta Pompeo

dhe nënpresidenti Mike Pence, e kanë akuzuar Rusinë se po punon kundër udhëheqësit të opozitës, Juan Guaido, duke mbështetur presidentin Nicolas Maduro.

Uashingtoni e akuzon Rusinë se po përpiqet ta rrisë influencën në hemisferën perëndimore përmes veprimeve në Venezuelë. Sekretari Pompeo mbërrin sot (e hënë) në Rusi, ku do të takohet me diplomatë amerikane në Ambasadën amerikane në Moskë, para takimit me përfaqësues të biznesit amerikan në



kryeqytetin rus. Ai do të vendosë një kurore të Varri i Ushtarit të Panjohur në nderim të atyre që

luftuan kundër nazizmit. Nesër (e martë) Sekretari amerikan i Shtetit Mike Pompeo

do të shkojë në Soçi për të biseduar me presidentin Putin dhe ministrin e Jashtëm rus, Sergei Lavrov. Kjo vizitë e sekretarit Pompeo zhvillohet ndërkohë që kanë filluar përgatitjet për takimin e G-20 në Osaka të Japonisë ku do të marrin pjesë presidenti amerikan Donald Trump dhe homologu i tij rus, Vladimir Putin. "Është në interesin tonë të kemi marrëdhënie më të mira me Rusinë", tha një zyrtar i lartë amerikan. "Kur kemi shqetësime, do t'i ngremë direkt, do të përpiqemi t'i ngushtojmë mospajtimet dhe të gjejmë fusha bashkëpunimi", tha ai.

Zyrtari nuk pranoi të bënte komente lidhur me mundësinë e një takimi mes dy presidentëve ndërkohë që ndodhen në Osaka për takimin e G-20.

Rohani fton për unitet pas përkeqësimit të gjendjes ekonomike

TEHERAN, 12 MAJ - Presidenti i Iranit, Hassan Rohani ka bërë thirrje për unitet ndërmjet fraksioneve politike të vendit, pas përkeqësimit të gjendjes ekonomike si pasojë e sanksioneve të vendosura nga Shtetet e Bashkuara. Rohani tha se "presionet nga armiqtë është një luftë e paprecedentë në historinë tonë të Revolucionit Islamik", rapor-

toi agjencia shtetërore e lajmeve, IRNA. "Sot, nuk mund të thuhet nëse kushtet janë më të mira apo më të këqija sesa në periudhën e luftës (lufta me Irakun 1980-88), por gjatë luftës ne nuk kemi pasur probleme me bankat tona, me shitjen e naftës, me importet dhe eksportet, atëherë ka pasur vetëm sanksione mbi blerjen e armëve", tha presidenti iranian,



teksa po fliste para disa aktivistëve të grupeve të

ndryshme të interesit. "Por, unë nuk dëshpërohem dhe kam shpresë të madhe për të ardhmen tonë dhe besoj se mund t'i tejkalojmë këto vështirësi nëse bëhemi bashkë", tha Rohani.

Kriza ekonomike në Iran është përkeqësuar, që prej se ShBA-ja u largua nga marrëveshja bërthamore ndërmjet Teheranit dhe fuqive botërore dhe riven-

dosi sanksionet ekonomike. Sanksionet mbi eksportet e metalit dhe të naftës së Iranit kanë për qëllim të rrisin presionin mbi Teheranin, që të heqë dorë, nga siç i cilëson Uashingtoni "aktivitetet malinje", të tilla si zhvillimi i armëve bërthamore dhe financimi i aktiviteteve militante në rajon. Teherani i hedh poshtë këto akuzat të Uashingtonit.

Lituania mban zgjedhjet presidenciale

Vilnius, 12 maj - Në Lituani të dielën janë mbajtur zgjedhjet presidenciale. Votuesit kanë pasur mundësi të zgjedhin në mesin e nëntë kandidatëve për të zëvendësuar presidenten aktuale, Dalia Grybauskaitė, e cila nuk mund të garojë më për këtë post, pasi ka qëndruar në krye të shtetit për dy mandate pesëvjeçare.

Nëse asnjëri prej kandidatëve nuk arrin të fitojë më shumë se 50 për qind të votave, raundi i balotazhit do të mbahet më 26 maj, datë që përkon edhe me

zgjedhjet që do të mbahen për Parlamentin Evropian. Sipas sondazheve, kandidatët favorit janë, ish-ministrja e Financave, konservatorja Ingrida Simonyte, kryeministri aktual, Saulius Skvernelis dhe ish-ekonomisti Gitanas Nausėda. Sipas sondazheve Simonyte pritet të fitojë 26 për qind të votave dhe pas saj pritet të dalin Nausėda dhe Skvernelis.

Në Lituani, presidenti nuk ka shumë fuqi ekzekutive, megjithatë, presidenti i vendit është përgjegjës për politikën e

jashtme dhe përfaqëson vendin në samitet e Bashkimit Evropian. Presidenti në Lituani po ashtu emëron ministrin, gjykatësin, shefat e ushtrisë, kreun e bankës qendrore dhe të gjitha këto emëime zakonisht bëhen me miratimin e Parlamentit apo të kryeministrit. Lituania, një aleate e ngushtë e Shteteve të Bashkuara, ka marrëdhënie të tensionuara me Rusinë fqinje. Në Lituani, muajt e fundit, disa persona janë arrestuar nën akuzat se kanë spiunuar për Moskën.

NATO-ja ka rritur praninë e saj në



Evropën Lindore dhe Qendrore, përfshirë edhe në Lituani, pas

aneksimit të Gadishullit Ukrainas të Krimesë nga Rusia më 2014.



BeyAb for bread

Risi, tani BEYAB-in mund ta gjeni edhe nëpër dyqanet e Kosovës. BeyAb është prodhim turk, dhe përpos tregut në Shqipëri e Mal të Zi tani edhe në Kosovë.



E jashtëzakonshme

Gjendet në Britani thesari romak

Një grumbull monedhash romake të shekullit të katërt u zbuluan nga dy amatorë, zbulues thesaresh. Kjo është shuma më e madhe e këtij lloji që gjendet në Britani. Zbulimi u bë në korrik të vitit 2017 pranë fshatit Raucedon në Lincolnshire nga 59-vjeçari Rob Jones dhe shoku i tij Craig Paul, 32 vjeç dhe që nga java që lamë pas janë pjesë e thesarit të shtetit. Arkeologu i Këshillit të Qarkut Lincolnshire, dr. Adam Daubney, ka



thënë se monedhat mund të jenë varrosur si pjesë e një rituali ceremonial.

FOTO E DITES



Një aeroplan i 'Miami Air International' Boeing 737-800 nuk mundi të ndalet në pistën në NAS Jacksonville dhe ra në lumin St Johns në Jacksonville në Florida. /Reuters/

BARSOLETA E DITËS



Policia: Mirëmbërëma, a keni ndonjë gjë që nuk duhet ta keni në veturë? Shoferi: Po zotëri polic! Gruan.




Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjate vikendit ne ora 14:00

“DUMBO” 3D

Fantazi/Familjar; 1 ore 52 min

Rolet: Colin Farrell, Michael Keaton, Danny DeVito, Eva Green, Alan Arkin, etj.
Regjia: Tim Burton



Ne ora 16:00 dhe 19:00

“AVENGERS; Endgame”

Aksion/Aventurë/Fantazi; 3 ore 02 min

Rolet: Robert Downey Jr., Chris Evans, Mark Ruffalo, Chris Hemsworth, Scarlett Johansson, Don Cheadle, Bradley Cooper, Gwyneth Paltrow, Jeremy Renner, Josh Brolin, etj.
Regjia: Anthony Russo, Joe Russo



Në ora 20:00

“EXTREMELY WICKED, SHOCKINGLY EVIL, AND VILE”

Krim/Mister; 1 ore 48 min

Rolet: Zac Efron, Lily Collins, Kaya Scodelario, Jeffrey Donovan, Angela Sarafyan, Dylan Baker, John Malkovich, etj.
Regjia: Joe Berlinger



E rrallë

Veterinerët realizojnë me sukses kirurgji truri te papagalli

Kirurgët kanë kryer një ndërhyrje në trurin e një papagalli që vlerësohet si specie në zhdukje. Qëllimi i tyre është që të provonin nëse procedura funksiononte në mënyrë që t'i shpëtonin speciet. Te zogu që kishte një vrimë në kafkë ata përdorën të njëjtat procedura si te njerëzit dhe gjarret e



tjerë. Kirurgjia që u realizua javën e kaluar ishte një sukses i veterinerëve.



16.05.2019

“THE HUSTLE”

Komedi

Rolet: Anne Hathaway, Rebel Wilson, Alex Sharp, Dean Norris, etj.

Regjia: Chris Addison

Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

 <p>DASHI Vendosni pak rregull në ditën tuaj sot dhe programoni ato që do të bëni. Dëshironi të rri në shtëpi dhe të shijoni ditën me njerëzit e dashur.</p>	 <p>DEMI Sot do të veproni sipas asaj që ju thotë zemra, pavarësisht këshillave që do t'ju japin miqtë. Një ndjenjë e re paraqitet në horizont.</p>	 <p>BINJAKËT Dikush po mendon shumë për ju sot. Fati është në anën tuaj kështu që mund të veproni si në karrierë edhe në dashuri.</p>	 <p>GAFORRJA Nervozizmi dhe tensioni sot do të shoqërojnë ditën tuaj. Në raportin në çift ka diçka që ju shqetëson si juve edhe partnerin.</p>	 <p>LUANI Keni qenë shumë të ngarkuar me punë gjatë kësaj periudhë. Vendosni të bëni disa ditë pushim që do t'ju qetësojnë shumë.</p>	 <p>VIRGJERESHA Nuk është momenti ideal për të kërkuar borxh ose për të marrë kredi. Disa probleme financiare në të ardhmen do t'ju shqetësojnë.</p>
 <p>PESHORJA Sot një kënge do t'ju ngjalle kujtime shumë të bukura. Po ndjeni nostalgji për një person që ka qenë i rëndësishëm në jetën tuaj.</p>	 <p>AKREPI Optimizmi juaj sot do të jetë ngjites. Në ambientin ku jeni do të ketë shumë humor dhe alegri. Çdo gjë do të kalojë këndshëm.</p>	 <p>SHIGJETARI Dita ideale për të mësuar gjëra të reja. Do të jeni në zbulim të vetvetes dhe kjo gjë do t'ju bëjë njerëz më të mirë.</p>	 <p>BRICJAPI Jeni duke pritur personin e duhur në jetën tuaj. Shikoni përreth sepse mund të jetë shumë më pranë nga sa mendoni.</p>	 <p>UJORI Nëse keni tradhtuar një mik, sot është dita kur kjo gjë do të zbulohet. Nuk do të mund të rregulloni dot gjërat që tashmë janë thyer.</p>	 <p>PESHQIT Sot nuk duhet të tregoni shumë gjëra nga vetja tek persona që sapo i keni njohur. Mund t'i keqpërdorin në të ardhmen.</p>

Keanu Reeves tregon se pse ndihet si kafshë e mbyllur në kafaz



Aktori i famshëm Keanu Reeves, në një intervistë për "The Sunday Telegraph", ka treguar për pjesën e zezë të të qenurit i famshëm. Reeves ka pohuar se në disa raste ai ndihet si një kafshë në

kafaz pasi, sipas tij, ka shumë njerëz dhe paparaci që rrinë jashtë shtëpisë së tij. "Unë dal jashtë në mëngjes ta marr gazetën. Dhe aty ka shumë njerëz. Ata më bëjnë të ndihen si një kafshë në kafaz", ka thënë Reeves.



Beyoncé dhe Jay-Z shijojnë një ndeshje basketbolli

Beyoncé dhe burri i saj Jay Z ishin bashkë për të parë një lojë basketbolli. Çifti u pa në Toyota Center në Houston, të Texas për ta parë

ndeshjen Golden State Warriors vs. Houston Rockets. Beyoncé dhe Jay Z u panë duke buzëqeshur dhe brohoritur për ekipin e tyre.

Menaxheri i Ariana Grandes tani ka nën mbikëqyrje edhe Demi Lovaton



Këngëtarja e njohur Demi Lovato me anë të një postimi në rrjetin social "Instagram" ka bërë me dije se tani është me menaxher të ri të muzikës dhe se do të fillojë një kapitull të ri. Lovato ka thënë se ndihet e lumtur dhe e

inspiruar për këtë kapitull të ri me menaxherin Scooter Braun. "Djema! Ëndrrat u bënë realitet sot për mua. Unë zyrtarisht kam një menaxher të ri. Dhe jo çfarëdo menaxheri, por një dhe të vetmin, Scooter Braun", ka shkruar ajo.

Drake prezanton aeroplanin e vet



Drake ka lansuar aeroplanin e vet të ri. Reperi 32-vjeçar përmes "Instagram"-it ka publikuar një video duke treguar se si duket aeroplani i tij i ri. Aeroplani kushtoi hiç më pak se 185 milionë dollarë dhe ka simbolin e OVO-s.



Gratë në rrezik, misteri i bandave “gërsheta prerëse” në Indi!

Autoritetet kanë ofruar një shpërblim prej 8,000 për këdo që ndihmon policinë të gjejë bandat. Ndërkohë, megjithatë, kanë nisur linçimet masive...

Spërkatje narkotike, shami të lagura me pilula gjumi, sulme mbi shpatullat dhe një qëllim i vetëm: të presin flokët e grave, të cilat pastaj e gjejnë veten në një shtrat të spitalit të habitura. Kjo është ajo që ndodh me prerjen e flokëve të tyre, ku gjatë gjashtë javëve të fundit ka përfshirë 200 viktima në shtetin e Kashmirit, një zonë e nxehtë e Indisë për shkak të luftës midis ushtrisë dhe separatistëve. Autoritetet kanë ofruar një shpërblim prej 8,000 për këdo që ndihmon policinë të gjejë bandat. Ndërkohë, megjithatë, linçimet masive kanë filluar të përipiqen për të kapur njerëzit e veshur me të zeza që sulmojnë gratë dhe i privojnë ata nga gërshetat e tyre të mbledhura nën vel. Dhe shpesh, ata janë viktima të pafajshme.

Rastet – Gratë nuk sulmohen vetëm në rrugë, por edhe në shtëpitë e tyre. Ashtu si studentja Naira Nazir, e gjetur pa ndjenja në dhomën e saj, pa gërsheta. Pastaj është rasti i Shaqeela Sajad, 24 vjeç, shtatzënë dhe

tashmë nënë e një fëmije: ajo ishte duke fshirë verandën në shtëpinë e saj në Srinagar – në Kashmir – kur një njeri i maskuar e sulmoi duke shtypur një shami në hundën e saj. “Kur u zgjova në spital, kuptova se gërsheta ime ishte zhdukur”, tha Shaqeela për ‘USA Today’. Vend i njëjtë, viktimitë e ndryshme. Gjithashtu në Srinagar, 37-vjeçarja Shafeeja u sulmua nga dy burra të maskuar ndërsa ishte duke hedhur mbetjet e darkës në plehra. Njëri prej tyre solli një kanistër në vrimat e hundës. Pjesa tjetër e skenës është një skenar që tashmë është parë: viktima u zgjua në spital pa flokë.

Linçimet masive – Ndërkohë, linçimet masive kanë filluar të përipiqen për të gjetur dhe ndëshkuar burrat “e zinj”, të cilët janë duke terrorizuar gratë. Megjithatë, në shumicën e rasteve bëhet fjalë për viktima të pafajshme. Ashtu si 70-vjeçarja Abdul Salam Ēani, i ngatërruar për një “gërsheta prerëse”, ndërsa ai po shëtiste në një qoshe dhe u vra me një tullë



në kokë nga nipi i tij. Ose edhe Nayeem Ahmed Malla: 20-vjeçari kishte shkuar për të parë të dashurën e tij, por ai ishte bllokuar, rrethuar dhe masakruar nga një grup “ekzekutuesish”. Edhe një grup i të huajve (tre australianë, një irlandez, një korean dhe një anglez) është gabuar për një bandë “gërsheta prerëse”. Pasi kishin humbur, djemtë kishin ardhur në fshatin e tyre në orën 2 të mëngjesit: në një kohë të

shkurtër ata ishin rrethuar nga “ekzekutuesit”. Pastaj, për fat të mirë, arriti policia.

E verdha – Nuk është e qartë se pse këta njerëz sulmojnë gratë dhe pastaj i privojnë ata nga gërshetat e tyre. Gërsheta që lihen pranë viktimitë dhe nuk janë vjedhur. Autoritetet indiane janë kontradiktore: flasin për histerinë masive dhe në të njëjtën kohë ofrojnë një shpërblim bujar. Disa udhëheqës sep-

aratistë, nga ana tjetër, flasin për komplot dhe akuzojnë qeverinë indiane se duan të ngjallin panik midis familjeve, për të parandaluar që të mbajnë rebelë separatistë në shtëpitë e tyre. Ushtria mohon të gjitha përgjegjësitë, ndërsa drejtuesi i përgjithshëm i forcës policore që merret me hetimin – dhe që ende nuk ka arrestuar askënd – bën shaka: “Unë jam duke kërkuar për një jaadu ki chadi (një shkop magjik)”. *Gazeta Shqip*

Njihuni me hotelin - fluturues luksoz



Zinxhiri i hoteleve luksoze të “Four Seasons” ka në plan të nisë një “hotel fluturues” me 5 yje për të lejuar transferimin e klientëve më të mirë me të gjitha komoditetet për të vizituar qytetet. Aeroplani i përdorur, një Airbus me 48 vende, ofron kolltuqe prej lëkure që mund të shndërrohen në shtretër, banjo ekstra luksoze dhe, mbi të gjitha, një trajtim VIP dhe hapësirë të mjaftueshme: ideja është të kombinojë “magjinë e udhëtimit ajror me një dizajn të kujdesshëm dhe duke u përqëndruar tek pasagjeri”.



Foto lajm/Shqiponja ngre në ajër qengjin



Pamjet e një shqiponje të madhe që ngre në ajër një qengj janë kapur në Skoci dhe ka shtuar frikën tek banorët e


zonë se zogjtë e fuqishëm mund të grabisin kafshët e tyre. Momenti i rrallë është kapur në Isle of Mull, Skoci nga

fotografi amator Douglas Currie, 74 vjeç, eksa ndodhej për pushime me bashkëshorten.

Sekretet në pikturat e Leonardo Da Vinçit

Leonardo Da Vinci ka përfunduar vetëm rreth 20 piktura në jetën e tij. Shumë prej veprave të tij më të mëdha mbetën të papërfunduara ose të shkatërruara. Megjithatë, ai bëri qindra vizatime që mbulonin një sërë aspektesh të pabesueshme, nga anatomia në botanikë, nga

bëdhjetë muze dhe galeri në të gjithë Mbretërinë e Bashkuar po krijojnë mini-ekspozita të tyre, secila prej të cilave përfshin dymbëdhjetë vizatime nga koleksioni kryesor. Se si Mbretëresha erdhi në këtë bartje të paçmuar, është pak e mistershme. Kur Leonardo vdiq në vitin 1519, ai



skulptura në arkitekturë, dhe tani ju mund të shihni një përzgjedhje të tyre afër dhe personalisht, në një muze apo galeri pranë jush.

Madhëria e saj Mbretëresha zotëron rreth 550 vizatime të Leonardos, një koleksion që ka qenë në Familjen Mbretërore që nga shekulli i 17-të.

Zakonisht ata janë mbajtur në Windsor Castle, por këtë verë, për të shënuar 500 vjet që nga vdekja e Leonardos, rreth 200 t? tilla do të shfaqen në Galerinë e Mbretëreshës në Buckingham Palace (një version më i vogël i kësaj ekspozite do të udhëtojë në Galerinë e Mbretëreshës në Holyroodhouse në vjeshtë).

Por ju nuk keni nevojë të prisni deri në verë për të parë disa nga këto vizatime. Përpara shfaqjes së Pallatit të Buckinghamit në maj, dym-

la përmbajtjen e studimit të tij tek nxënësi i tij, Francesco Melzi. Kur Melzi vdiq, rreth vitit 1570, vizatimet e Leonardos u blenë nga një skulptor i quajtur Pompeo Leoni, i cili i mori ato në Madrid.

Leoni i ndau këto vizatime në dy albume. Pas vdekjes së Leonit, në vitin 1608, një album përfundoi në Biblioteca Ambrosiana në Milano; tjetri u ble nga Thomas Howard, Earl of Arundel (mund të jetë sjellë në Britani nga Charles I, i cili shkoi në Madrid në vitin 1623 për të gjetur një nuse dhe u kthye me një ngarkesë arti). Albumi në Milano është më i madh, por ai i blerë nga Howard është koleksioni më i plotë, deri tani.

Ne e dimë që Howard i kishte këto vizatime në 1630, por deri në vitin 1690 ato ishin në



Pallatin Whitehall, në koleksionin mbretëror të Uilliam III. Si përfunduan ato atje? Askush nuk e di me siguri, por shpjegimi më i mundshëm është se ato i janë dhënë Çarlsit II nga nipi i Howardit, Duka i Norfolkut, për t'i kthyer favorin Monarkut? Rivendosjes. Deri në fund të shekullit të 19-të, kur koleksioni Windsor u botua për herë të parë në riprodhim, Leonardo ishte me të vërtetë një figurë gjysmë-mitike.

Askush nuk i kushtoi shumë vëmendje këtyre vizatimeve deri në vitet 1830, kur ata përfunduan në bibliotekën e re mbretërore në Windsor Castle. Këtu në Windsor atao ishin kataloguar siç duhet, dorëshkrimet shoqëruese u transkriptuan dhe vetëm atëherë u shfaq rëndësia e tyre e vërtetë.

"Shumica e asaj që dimë rreth Leonardo vjen nga koleksioni Windsor", thotë Martin Clayton, Shefi i Printimeve dhe Vizatimeve në Koleksionin

Mbretëror dhe kuratori i kësaj ekspozite.

"Megjithëse dihej dhe përmendet nga biografët e hershëm, nuk është deri në fund të shekullit të 19-të që ky koleksion është publikuar së pari në riprodhim dhe shënimet janë përkthyer. Deri në atë pikë, Leonardo ishte me të vërtetë një figurë gjysmë mitike. "Darka e Tij e Fundit (jo Mona Lisa) ishte piktura e tij e vetme që ishte e njohur gjerësisht.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045 82 82 82

Vushtrria rikthehet në Superligë, afër edhe Dukagjini

Liga e Parë në futboll ka qenë shumë interesante në këtë edicion. Vushtrria ka pësuar humbje, por e ka siguruar inkuadrimit në Superligë, kurse një gjë të tillë është afër ta bëjë edhe Dukagjini i Klinës. Dy skuadrat e tjera nga Rrafshi i Dukagjinit, Besa dhe Vëllaznimi, e kanë siguruar barazhin, por ende mund të luftojnë për pozitën e dytë



"Epoka e re"

PRISHTINË, 12 MAJ - KF Dukagjini nga Klina ka bërë një hap të madh drejt inkuadrimit në IPKO Superligën e Kosovës në futboll, pasi e ka fituar ndeshjen ndaj lideres në Ligën e Parë, Vushtrrisë (4-3). Ndeshja e zhvilluar në Klinë u përcoll nga një numër i madh i shikuesve dhe shtatë golat e shënuara e arsyetuan epitetin e derbit. Për skuadrën e Dukagjinit hero i vërtetë ishte Granit Elezaj, pasi shënoi katër golat për skuadrën e tij, kurse për mysafirët golashënues ishin Kastriot Selmani, Dren Ahmeti dhe Diore Zaberxha. Pas kësaj fitore Dukagjini e "prek" Superligën, pasi ka grumbulluar 59 pikë, katër pikë më shumë se Besa e

Pejës që zë vendin e tretë në tabelë. Në anën tjetër, skuadra e Vushtrrisë, edhe përkundër humbjes, e siguroi edhe matematikisht inkuadrimit në elitë. Një tjetër derbi u zhvillua të dielën në Gjakovë, kurse fitore shënoi Vëllaznimi me rezultat bindës 4-0 ndaj Besës. Nga dy gola për skuadrën kuqezi i realizuan Almedin Murati dhe Kushtrim Gashi. Pas kësaj fitore, Vëllaznimi e siguroi, së bashku me skuadrën pejane, barazhin për inkuadrimit në elitë, sepse skuadra e pestë në tabelë, Vitia, pësoi humbje të papritur nga Kika me rezultat 3-1. Garë interesante po zhvillohet për mbetjen në Ligën e Parë, kurse me shumë se gjysma e skuadrave ende nuk e kanë të sigurt mbetjen në këtë rang garash, kur kanë mbetur të zhvillohen edhe dy ndeshje deri në fund të kampionatit.

LIGA E PARË

Drenasi - 2 Korriku	3-1
Arbëria - Trepça	0-0
Onix - Istogu	2-3
Vëllaznimi - Besa	4-0
Dukagjini - Vushtrria	4-3
Ramiz Sadiku - Bashkimi (K)	2-1
Fushë Kosova - Vllaznia	1-0
Kika - Vitia	3-1

TABELA

		PIKË
1. Vushtrria	28	63
2. Dukagjini	28	59
3. Besa	28	55
4. Vëllaznimi	28	54
5. Vitia	28	47
6. Onix	28	37
7. Trepça	28	35
8. Istogu	28	35
9. Fushë Kosova	28	34
10. Arbëria	28	34
11. Drenasi	28	32
12. 2 Korriku	28	32
13. Ramiz Sadiku	28	30
14. Kika	28	29
15. Vllaznia	28	28
16. Bashkimi (K)	28	26

SHKURT

"Epoka e re" mposhti për herë të dytë "Klan Kosovën"

Liderja e Media Ligës, "Epoka e re", e ka fituar derbin ndaj "Klan Kosovës" me rezultat 4-2. "Klan Kosova" ishte në avantazh të dy golave, por ekipi i "Epokës së re" arriti ta përmbyste rezultatit dhe në këtë mënyrë t'i ofrohet titullit në këtë garë. Kjo është hera e dytë në këtë kampionat që "Epoka e re" e mposhti "Klan Kosovën" derisa në ndeshjen e parë kishte fituar me rezultat bindës 7-2.

Hamiltoni triumfon në Spanjë

Lewis Hamiltoni ka triumfuar në Çmimin e Madh të Spanjës dhe ka marrë fitoren e tretë të këtij sezoni. Piloti anglez është ngjitur në vendin e parë të renditjes dhe ka një avantazh prej shtatë pikësh ndaj Bottas. Britaniku ka shkatërruar shokun e tij të skuadrës, i cili e ka nisur garën nga vendi i parë, në fundjavën e radhës të dominuar nga Mercedesi. Vendi i tretë është marrë nga Red Bull i Verstappenit, ndërsa ka zhgënjyer Ferrari me Vettelin dhe Leclerci që kanë zënë respektivisht vendet katër dhe pesë.

Haxhi Krasniqi humb titullin e Evropës

Boksieri shqiptar Haxhi Krasniqi nuk ka arritur ta mbrojë titullin e kampionit të Evropës në meçin e sotëm kundër Stefan Haertelit. Me vendim unanimit të gjyqtarëve kampioni i ri i Evropës në kategorinë e mesme është shpallur Haertel, që mori më shumë pikë se Krasniqi. Krasniqi u lëndua qysh në fillim në këtë meç, megjithatë luftoi për 12 raunde ndaj Haertelit. Ky ishte meçi i tij i 55, prej të cilëve ka shënuar 49 fitore, nga të cilat 17 me nokaut.

Akili humbi luftën për të bronzën, Lorianë eliminohet në raundin e parë

Akil Gjakova nuk ka arritur të rrëmbejë medalje në Grand Slamin që po mbahet në Baku të Azerbajxhanit. Në repesazhë për medalje të bronzit ai u mposht nga nikoqiri Rustam Orujov, i cili është edhe medalist i argjendtë në Lojërat Olimpikë Rio 2016. Lorianë Kuka është eliminuar nga Grand Slami i Bakusë pasi u mposht në raundin e parë nga xhudistja Katie-Jemima Yeats-Brown të dielën në mëngjes.

Partizani shpallet kampion i Shqipërisë pas 26 vjetësh

TIRANË, 12 MAJ - Kryeqyteti i Shqipërisë, Tirana, ngjyrosset me "të kuqe". Triumfi 2-1 i Partizanit ndaj Tiranës në superndeshjen e javës së 33-të të Kategorisë Superiore për

sezonin 2018-2019 zyrtarizoi njëkohësisht edhe titullin kampion për "Demat e kuq", që rikthehen kështu t'i gëzohen një trofeu pas 26 vjetësh. Dygolëshi i shënuar nga Cinari, që trondi-

ti rrjetën e bardhebluve një herë në pjesën e parë dhe një herë në të dytën, pavarësisht se Tirana barazoi përkohësisht në fundin e 45-minutëshit të parë me anë të Grecës, bëri që duelin

kryeqytetas ta fitonin "të kuqtë", njëkohësisht të kurorëzoheshin kampionë të futbollit shqiptar. Në "Selman Stërmasi", menjëherë pas vërsëllimës së fundit të arbitrit të

ndeshjes, ka shpërthyer festa e shumëpritur e tifozëve të Partizanit, një sukses i merituar dhe tejet i arritur, pasi vjen tri javë nga fundi i kampionatit shqiptar të futbollit.

Valmir Veliu: Do të rikthehem edhe më i fortë

PRISHTINË, 12 MAJ - Lojtari i KF Llapit, Valmir Veliu, i cili u lëndua në ndeshjen Prishtina - Llapi, nëpërmjet rrjeteve sociale ka konfirmuar se është në gjendje të mirë

shëndetësore. Futbollisti Veliu ka falënderuar doktorët Afrim Shabani dhe Murat Berisha për kontributin e madh që kanë dhënë që ai t'i shpëtojë më të keqes. Ai, po

ashtu, falënderoi familjen, skuadrën e Llapit në krye me trajnerin Tahir Batatina dhe të gjithë ata që u interesuan për gjendjen e tij. "Ju premtoj se do të kthehem edhe më

i fortë për ta vazhduar ëndrën prej aty ku e lamë. Dashnia juaj më bën më të fortë. Shihemi përsëri në fushat e blerta!", ka shkruar Veliu.



Prishtina 'nxjerr' Llapin nga gara për titull, s'gabon Feronikeli



PRISHTINË, 12 MAJ - Të shtunën janë zhvilluar tri ndeshjet e fundit të javës së 31-të në IPKO Superligën e Kosovës në futboll. Në derbin e kësaj xhiroje që u zhvillua në stadiumin "Fadil Vokrri" ndërmjet Prishtinës dhe Llapit, fitores iu gëzuan futbollistët e Prishtinës me rezultat 1-0. Golin e tri pikëve të mëdha në garën për titull për bardhekaltrit e kryeqytetit e shënoi Mërgim Pefçeli në minutën e 88. Ndërsa skuadra kryesuese, Feronikeli, ka shënuar fitore para tifozëve të vet në duel me Dritën, me rezultat 4:1, duke e ruajtur pozitën e parë në renditje edhe pas

kësaj jave. Feronikeli kaloi në epërsi në minutën e 33-të, me golin e shënuar nga Kastriot Rexha. Epërsinë në 2:0 e shtoi Jean Carioca Da Silva pas vetëm dy minutash lojë në pjesën e dytë. Më pas ishin mysafirët që shënuan kur Filonit Shaqiri shënoi një supergol nga distanca, kur po zhvillohej minuta e 61-të. Megjithatë, në minutat në vazhdim Feronikeli u tregua më këmbëngulës dhe arriti të shënojë edhe dy herë, nëpërmjet Kastriot Rexhës (74') dhe Mendurim Hoti (84'). Ndërkohë, ndeshja në Prizren, ndërmjet dy skuadrave që edicionin e

IPKO SUPERLIGA	
Prishtina - Llapi	1-0
Feronikeli - Drita	4-1
Liria - KEK-u	3-1
Flamurtari - Drenica	0-0
Ballkani - Gjlani	1-0
Trepça '89 - Ferizaj	1-2

TABELA		
		PIKË
1. Feronikeli	31	74
2. Prishtina	31	72
3. Llapi	31	69
4. Drita	31	48
5. Ferizaj	31	40
6. Drenica	31	39
7. Ballkani	31	39
8. Trepça '89	31	39
9. Flamurtari	31	39
10. Gjlani	31	35
11. Liria	31	28
12. KEK-u	31	1

Në xhiron e radhës takohen: Prishtina-Trepça '89, Llapi-Feronikeli, Drita-Flamurtari, Drenica-Ballkani, Gjlani-Liria, KEK-u-Ferizaj.

ardhshëm do të garojnë në një kategori më poshtë, Lirisë dhe KEK-ut, u mbyll me fitoren e prizrenasve me shifrat 3-1. Golat për Lirinë i shënuan Fatih Karahoda (15') dhe Liridon Fetahaj (31', 90'), kurse golin e vetëm për KEK-un e shënoi Rilind Nimani (85').

City mbron titullin në Premierë Ligë



MANCHESTER, 12 MAJ - Manchester City është shpallur kampion i Premierë Ligës pasi në ndeshjen e fundit e mposhti skuadrën e Brightonit (1-4). Vendësit realizuan të parët nëpërmjet Glenn Murray, por City reagoi shpejt duke realizuar në pjesën e parë dy gola me anë të Agueros dhe Laportes. Në pjesën e dytë Mahrezi dhe Gundogan shënuan edhe dy gola për ta kompletuar fitoren e Cityt, e cila ka vlerën e titullit. Fitore shënuan edhe Liverpooli ndaj Wolvesit (2-0), por kjo fitore mbetet e pavlerë për faktin se City e përfundoi kampionatin

në vendin e parë, kurse "Reds" në vend të dytë me një pikë me pak. Chelsea barazoi me Leicester Cityn 0-0, por kampionatin e mbylli në pozitën e tretë, pasi edhe Tottenhami barazoi ndaj Evertonit (2-2). "Spursi" përfundon në pozitën e katërt, derisa Arsenali përfundoi në pozitën e pestë edhe përkundër që e mposhti Burnleyn (1-2). Arsenali dhe Manchester Unitedi përfundojnë në dy pozitë që i dërgojnë në Ligën e Evropës, kurse nga Premierë Liga kanë rënë Cardiff City, Fulhami dhe Huddersfield Town.

PREMIERË LIGA	
Brighton - Manchester City	1-4
Burnley - Arsenal	1-3
Crystal Palace - Bournemouth	5-3
Fulham - Newcastle U.	0-4
Leicester City - Chelsea	0-0
Liverpool - Wolverhampton	2-0
Manchester United - Cardiff C.	0-2
Southampton - Huddersfield T.	1-1
Tottenham Hotspur - Everton	2-2
Watford - West Ham United	1-4

TABELA		
		PIKË
1. Manchester City	38	98
2. Liverpool	38	97
3. Chelsea	38	72
4. Tottenham H.	38	71
5. Arsenal	38	70
6. Manchester U.	38	66
7. Wolverhampton	38	57
8. Everton	38	54
9. Leicester City	38	52
10. West Ham	38	52
11. Watford	38	50
12. Crystal Palace	38	49
13. Newcastle U.	38	45
14. Bournemouth	38	45
15. Burnley	38	40
16. Southampton	38	39
17. Brighton	38	36
18. Cardiff City	38	34
19. Fulham	38	26
20. Huddersfield	38	16

SHKURT

Kastrioti, një hap drejt finales

Kastrioti i Ferizajt ka bërë hapin e parë drejt kalimit në finale të "play-off" në Superligën e Kosovës në hendboll (meshkujt). Kastrioti e ka mposhtur Prishtinën në Ferizaj në ndeshjen e parë gjysmëfinale të "play-off"-it. 28:21 në të mirë të Kastriotit ishte rezultati i takimit që vuri përballë dy finalistët e Kupës. Pas pjesës së parë ferizajasit kishin epërsi prej katër golave, 12:8. Terziqi me 8 gola ishte më efikas i Kastriotit. Gjashtë gola i shënoi Bassomben. Te Prishtina u dallua me efikasitet Beshiri me 6 gola.

Ajaxi, afër titullit në Holandë

Ajaxi ka fituar me rezultatin 4-1 ndaj Utrechtit duke hedhur një hap të sigurt drejt titullit kampion në Holandë, kur ka mbetur edhe një ndeshje për t'u zhvilluar. Ndërkohë PSV është mundur në fushën e AZ Alkmaarit me rezultatin 1-0. Skuadra e Erik Ten Hag e nisi keq duke e pësuar që në minutën e parë, por golat e Huntelaar dhe van de Beek përmbyshën shifrat që në pjesën e parë. Në të dytën ishte Dusan Tadiqi që shënoi dy herë të tjera për të siguruar fitore. Me këtë fitore Ajaxi ngjitet i vetëm në vendin e parë me 83 pikë, 3 më shumë se PSV dhe praktikisht është kampion në Eredivisie. Kur mbetet edhe një ndeshje, PSV duhet të fitojë ndaj Heraclesit 13-0 javën e ardhshme dhe Ajaxi të mundet 1-0 nga Graafschap, pasi diferenca e golave aktualisht është 14. Ajaxi do të mjaftojë edhe me një barazim ndeshjen e ardhshme për t'u shpallur kampion.

Van Dijk, lojtari i vitit në Premierë Ligë


Mbrojtësi i Liverpoolit, Virgil van Dijk, është shpallur lojtari më i mirë i sezonit 2018/2019 në Premierë Ligë. Reprerentuesi holandez po kompletton një sezon të jashtëzakonshëm në fanellën e Liverpoolit. Fitimi i këtij trofeu është diçka e rrallë në futbollin anglez, pasi hera e fundit që këtë e ka bërë një mbrojtës, ishte sezoni 2011/2012, kur Vicent Kompany i Manchester Cityt ishte zgjedhur më i miri.

Mulleri: Titulli është i Bayernit

Bayern Munchen humbi një mundësi të mirë për ta fituar zyrtarisht titullin kampion në Bundesliga për të 7-in vit radhazi me barazimin 0-0 që regjistroi në fushën e Leipzigut. Megjithatë, "bavarezëve" do t'u mjaftonte qoftë edhe një barazim në sfidën e fundit ndaj Frankfurtit në "Alianz Arena". Një nga lojtarët më të rëndësishëm në skuadrën e Bayernit, Thomas Muller, është optimist se titulli do të jetë pronë e Bayernit edhe këtë sezon. "Ndaj Leipzigut bëme një paraqitje shumë të mirë, dominuam, por na mungoi vetëm goli. Mendoj se kjo ishte ndeshja më e mirë që kemi zhvilluar këtë sezon. Gjithsesi jam i sigurt se të njëjtën paraqitje do ta bëjmë edhe pas një jave në sfidën ndaj Frankfurtit dhe këtë herë mendoj se do të shpërblehemi duke fituar titullin kampion. Në skuadër ekziston një dëshirë shumë e madhe për të fituar", ka thënë Mulleri.

Vogeli, trajner i ri i Lakersave

Frank Vogel do të jetë trajneri i ri i skuadrës së Lakersit në NBA. Lajmi ende nuk është zyrtar, por ESPN konfirmon se drejtuesit e ekipit kalifornian kanë arritur marrëveshjen me trajnerin 45-vjeçar (do të zërë vendin e Luke Waltonit). Vogel do të nënshkruajë një kontratë trevjeçare me Lakersin dhe në stafin e tij do të jetë edhe një ikonë e NBA-së si Jason Kidd. Marrëveshja me Frank Vogelën ka befasuar të gjithë, pasi mendohet se kandidati kryesor dhe i vetëm në garë ishte Tyronn Lue (mësohet se ka refuzuar ofertën e ekipit kalifornian). Gjithsesi, duket se situata është përmbytur orët e fundit, pas një takimi që drejtuesit e Lakersit kanë pasur me trajnerin e ri. Firmat në kontratë do të hidhen vetëm pasi të zhvillohet edhe një takim i fundit, që do të organizohet javën e ardhshme në Los Anxhelos. Frank Vogel ka qenë më parë trajner i skuadrës së Indiana Pacersit (2011-2016) dhe më pas ka drejtuar skuadrën e Orlando Magicut (2016-2018). Sezonin aktual ai nuk ka pasur ekip. Në karrierën e tij si trajner ka arritur 304 fitore dhe 291 humbje.

Autor: GAZMEND MORINA	DIPLOMATI I NDJERË AMERIKAN NË FOTO	VINÇ	DIÇKA QË ËSHTË E VËRTETË (shq.)	EPOKË (shq.)	MOSHË E RE	ANITA TAKE	BANOR I NJË QYTETI SHQIPTAR NË MAQEDONI	EPOKA ERE	BASHKËTING-ËLLORE	QË I PËRKET ETIKES, E ETIKËS	VARIOLA							
KUMTIM I GJERË ME SHKRIM, QË MBAHET PARA NJË MBLEDHJEJE	○							AKTORI HOLLIVUDIAN ... GIBSON NË KËTË MOMENT										
GAZ QË SHPËRTHEN KUR DIKUSH TALLET ME DIKË A ME DIÇKA	○								TITAN FILOZOF DHE MATEMATIKAN GREK									
VEGËL DORE, QË PËRBËHET NGA NJË KOKË METALI	○						DOKUMENTI I VJETËR MBI PRONËSINË E TOKËS PYLL											
ADVANCED VIDEO TECHNOLOGIES	○			SHALQI TË FRENUARIT								ELEMENT KIMIK						
EMËR YNI MASHKULLI (ANAGRAM I EMRIT ARIF)	○					AFROHET (bised.) ELDAR (shk.)												
DY BASHKËTINGËLLORE	○		DRAMATURGU ARBËRESHË JOSIP ... LLOJ, SOJ (sh.shq.)					ANDORA EMËR I VJETËR PËR LUBJANËN		ZANORE TRAJNERI HOLANDEZ ... HAN								
BUJTINË E MADHE	○					ISH PRESIDENTI AMERIKAN RONALD BUKUROSHJA VUTHAJ												
KËNGËTARJA HUTA	○						VDEKJE BASHKËTING-ËLLORE					EPOKA ERE	INSTITUCION I LARTË SHKENCOR	KËNGËTARJA RADI	BASHKIM I FORTË DHE I PANDASHËM (sh.shq.)	ISH MISS ALBANIA HYGERTA BINARI I TRENIT		
SHKRONJA XVII	○	3.14 (Mat.) QYTET I LASHTË NË ILIRI (shq.)				KËNGËTARJA E NJOHUR ESTEFAN PJESË E ILIRISË						FEMRA E ARIUT ALFRED KAÇINARI						
KLUB FUTBOLLI GJERMAN "WERDER"	○					NAIM ABAZI TAJLANDA, INDIA				QË FLET A QË SHKRUAN SHKURT E PRERË AKTORI ... CRUISE								
RITUAL	○			SHTRESË E HOLLË BRUMI NË TRAJTË TË RRUMBULLAKËT (shq.) KURESHTJE					BASHKËTING-ËLLORE QYTET NË SHQIPËRI (pashq.)		LOKAL LUKSOZ KU LUHET BIXHOZI TRIESTINA							
UGANDA, ZAMBIA	○		FEMRA E ZGJEDHUR NË NJË KONKURS BUKURIE QYTET NË ZVICËR					KOHË PA NDONJË DOBI				DITA E SHËNUAR NË KALENDAR KËNGËTARJA VALENTINA					SHTET NË EVROPË	
SËMUNDJE E RËNDË NGJITËSE	○					AKTORJA AM. BASINGER NDARJE NË NJË NDËRMARRJE PRODHUESE					AKTORJA HOLLIVUDIANE ZELLUEGER SHTETI MË I POPULLUAR NË BOTË					ZANORE ANIMACION		
EPOKA ERE	BOKSIERI SHQIPTAR ... SEFERI KRYENGRITJA KUNDER PUSHTETIT					DETYRË E AKTORIT IMBECILI, IDIOTI				INTERESI BANKAR NGA KREDIA (sh.shq.) ÌSH TRAJNERI YNË I BOKSIT LAH								
KRYEQYTETI I LETONISË						SHPËRTHIMI I FUQISHËM RADIUM									PJATA SEND QË SHËRBEU PËR ZBUKURIM (shq.)			
ZANORE		KAFSHË E VOGËL HELMUËSE ME NGJYRË TË ZEZË GOJËTAR						KËNGËTARJA AMERIKANË ... TARNER KA A DEM I PATREDHUR				MËNYRË E VEÇANTË E TË SHKRUARIT LUMË NË KOSOVË						
ISH KRYEQYTETI I GJERMANISË (pashq.)				KRYEMURG PJESA E NGRITUR E TEATRIT KU LUAJNË AKTORËT					MIMOZA AHMETI REKRUT NË PERANDORINË OTOMANE		ENEIDA TARIFA SHKENCËTARI NJUTON (shq.)		BREJTËS I VOGËL NIKEL					
KËNGËTARI ITALIAN RAMAZZOTTI						AKTORJA JONË CAHANI PËREMËR VETOR					QESËNDI ZANORE						LUMË NË MITROVICË	
NOTË MUZIKORE			KËNGËTARE E JONA E NJOHUR SHKRONJA XXIV															
PARA TË KATËRTIT							NJË KONTINENT SAMI KHEDIRA				VENDI KU LIDHEN ESHTRAT DY BASHKËTINGËLLORE		TONI ADAMS	BASHKËTING-ËLLORE MOR, HEJ				
"MOLDE"			NATRIUM BASHKËTING-ËLLORE			NUK KA (bised.) KANDAHARI					SKITAR ZANORE							
KËNGËTARJA LIBOHOVA						KUVENDI KOMUNAL		MI I VOGËL					100 M ²					



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Ministarstvo za Rad i Socijalne Zaštite Ministry of Labour and Social Welfare

Mbështetur në nenin 13 dhe 18 të Ligjit Nr. 03/L - 149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, dhe në Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Rishpall:

KONKURS

Titulli i punës: Udhëheqës i Divizionit të Komisioneve Mjekësore

Referenca: RN00004834

Departamenti i Pensioneve

Divizioni për Komisione Mjekësore

Koeficienti: H-725

Orari i punës: 1 plotë, 40 orë në javë

Kategoria funksionale: Niveli Drejtues

Akt Emërimi: Sipas Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës

I përgjigjet: Drejtorit të Departamentit të Pensioneve

Vendi: Prishtinë

Qëllimi i vendit të punës:

Udhëheqësi i Divizionit për Komisione Mjekësore bënë menaxhimin dhe administrimin e punës së të gjitha komisioneve mjekësore me qëllim të shqyrtimit të të gjitha kërkesave të aplikuesëve në skemat pensionale dhe sociale.

Detvat dhe Përgjegjësitë:

- Udhëheqësi i Divizionit për Komisione Mjekësore në përputhje me dispozitat ligjore përcakton standardet kualitative dhe kuantitative për komisionet mjekësore, përcakton standardet kuantitative dhe kualitative për kategoritë e caktuara të lëmive të ndryshme specialistikë, sipas kërkesave të aplikantëve, kuadrit shëndetësor, duke përfshirë edhe personelin ndihmës;
- Siguron Zbatimin e Procedurave Administrative dhe mjekësore në përputhje me legjislativon në fuqi;
- Administron punën e komisioneve mjekësore;
- Ndihmon në organizimin e takimeve për komisionet mjekësore;
- Propozon, harton dhe siguron zbatimin e kriterëve dhe procedurave për angazhimin e mjekëve në komisione mjekësore;
- Në pajtim me kriteret e përcaktuara, organizon procedurat për zgjedhjen e komisioneve profesionale mjekësore dhe cakton orarin për seancat e komisioneve mjekësore;
- Kompletion dhe mirëmban evidencën mjekësore për të gjithë shfrytëzuesit e të drejtave në skemat pensionale dhe sociale;
- Vendosijen dhe aplikimin e procedurave ligjore dhe mjekësore në përputhje me dispozitat e ligjeve të skemave pensionale dhe sociale, për shqyrtimin dhe rishqyrtimin e kërkesave për njohjen e të drejtave të aplikuesëve në skemat pensionale dhe sociale;
- Rregullimin dhe përcaktimin e procedurave për angazhimin e mjekëve në komisione mjekësore sipas kërkesave të departamentit përkatës të MPMS-së;
- Kryen edhe punë tjera në pajtim me qëllimin e vendit të punës të cilat mund të kërkohen kohë pas kohe nga mbikqyrsi i drejtpërdrejtë.

Kualifikimi, përvoja e punës, aftësitë dhe shkathtësitë tjera:

- Diplomë e Fakultetit të Mjekësisë drejtimi i internos, oftamologji, mjekësi e përgjithshme, mjekësi familare, kirurgji, psikiatri dhe drejtime tjera të ngjashme, së paku pesë(5) vite përvojë pune profesionale;
- Aftësi të mbikqyrë dhe trajnojë stafin e caktuar duke përfshirë organizimin, caktimin e prioritetëve, dhe delegimin e detyrave;
- Shkathtësi të shkëlqyeshme organizative dhe kordinuese;
- Shkathtësi të shkëlqyeshme administrative dhe udhëheqëse;
- Aftësi për të punuar si pjesë e ekipit;
- Njohje e gjuhës shqipe dhe serbe;
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Access).

Konkursi mbetet i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit në shtypin ditor dhe në Sistemin Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (SIMBNJ), nga data 13.05.2019 deri më 27.05.2019.

Formularët për aplikim merren në divizionin për burime njerëzore/MPMS dhe të plotësuar dorëzohen, çdo ditë pune nga ora 08:00-16:00, adresa: Rruga "Edit Durham" Nr. 46-Prishtinë, afër sheshit "Zahir Pajaziti" ndërtesa e MPMS-së.

Aplikacionet e dërguara me postë të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën ditën e fundit të afatit për aplikim do të konsiderohen të vlefshme nëse arrijnë brenda 4 (katër) ditësh. Aplikacionet e pakompletuara nuk do të shqyrtohen.

Aplikacionit i bashkangjiten kopje të dokumentacionit mbi kualifikimin, për përvojen e punës, dokumente tjera të nevojshme që kërkon vendi i punës për të cilën konkurrojnë kandidatët.

Kandidatët që ftohen në intervistë janë të obliguar të sjellin me vete dokumentet origjinale për verifikim para komisionit intervistues.

Kandidatët që hyjnë në përzgjedhje të ngushtë, do të informohen lidhur me intervistën nëpërmjet telefonit ose me shkrim në afat ligjor nga zyra e personelit.

Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femrore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Ministarstvo za Rad i Socijalne Zaštite Ministry of Labour and Social Welfare

Na osnovu članova 13 i 18 Zakona br. 03 / Z-149 o Civilnoj Službi Republike Kosovo, i Uredbi br. 02/2010 o Procedurama Rekrutovanja u Civilnoj Službi, Ministarstvo Rada i Socijalne Zaštite, Ponavlja:

KONKURS

Naziv rada: Rukovodioc Divizije Lekarske Komisije

Referencija: RN00004834

Departmant Penzije

Divizija Lekarske Komisije

Koheficienat: H-725

Radno vreme: Puno, 40 sati nedeljno

Funksionalna kategorija

Akt Imenovanja: Prema Zakonu o Civilnoj Službi Republike Kosovo

Izveštava: Rukovodiocu Penzijkog Departmana .

Mesto: Priština

Svrha radnog mesta: Rukovodilac Divizije za Lekarske Komisije vrši upravljanje i upravljanje rada svih lekarskih komisija radi razmatranja svih zahteva aplikantata u penzijskim i socijalnim šemama.

Zadaci i odgovornosti:

- Rukovodilac Divizije za Lekarske Komisije u skladu sa zakonom odredbama

- Upravlja rad lekarskih komisija;
- Pomaže u organizovanju sastanaka za lekarske komisije;
- Predlaže, izrađuje i obezbeđuje sprovođenje kriterijuma i procedura za angazovanje lekara u lekarskim komisijama;
- U skladu sa utvrđenim kriterijumima, organizuje procedure za odabir stručnih lekarskih komisija i određuje raspored za sednice lekarskih komisija;
- Kompletirati i održavati lekarsku evidenciju za sve korisnike prava u penzijskim i socijalnim šemama;
- Uspostavljanje i primena pravnih i lekarskih procedura u skladu sa odredbama penzionih i socijalnih šema, za razmatranje i ponovno razmatranje zahteva za priznavanje prava podnosilaca na penzijskim i socijalnih šema;
- Uređivanje i utvrđivanje procedura za angazovanje lekara u lekarskim komisijama u skladu sa zahtevima odgovarajućeg departmana MRSZ-e;
- Obavlja druge poslove u skladu sa svrhom radnog mesta koji se može s' vremena na vreme direktno zahtevati od direktnog nadzornika.

Kvalifikacija, radno iskustvo, veštine i druge veštine:

- Diploma Medicinskog Fakulteta, smer: Interno, Oftamologija, opšta medicina, porodica medicina, hirurgija, psikiatrija, drugih sličnih smerova sa najmanje pet(5) godina profesionalno radno iskustvo;
- Sposobnost nadziranja i obuku određenog osoblja, uključujući organizovanje i određivanje i delegiranje zadataka;
- Odlične organizacione i koordinacijske veštine;
- Sposobnost da radi kao deo tima;
- Odlične administrativne i rukovodeće veštine;
- Sposobnost raditi kao deo tima;
- Poznavanje Albanskog i Srpskog jezika;
- Računarske veštine u programskim aplikacijama (Word, Excel, Power Point, Access).

Konkurs ostaje otvoren 15 (petnaest) dana od dana objavljivanja u dnevnoj štampi, u Informacionom Sistemu za Upravljanje Ljudske Resurse, (ISULJR) od 13.05.2019 do 27.05.2019.

Aplikacioni obrazci mogu se uzeti u Diviziji Ljudskim Resursima MRSZ u prizemlje, i popunjene dostavljati, svakog radnog dana od 08:00 do 16:00 časova. Adresa: Ulica "Edit Durham" br 46 u blizini, trga "Zahir Pajaziti" zgrada MRSZ-te u Prištini.

Aplikacije koje su poslate poštom koja drže poštanski žig na pošiljci poslednjeg dana roka za prijavu smatraće se važećim ako dostignu u roku od 4 (četiri) dana. Aplikaciji dostaviti kopije kvalifikacione dokumentacije, radno iskustvo i druga neophodna dokumenta koja zahteva radno mesto za koje kandidat konkurisu. Nekompletirane aplikacije neće se razmatrati.

Kandidati pozvani na intervju su obavezni da sa sobom donesu originalnu dokumentaciju za verifikaciju pred komisijom za intervju

Kandidati koji ulaze u bliskoj selekciji, bice obavesteni o intervju preka telefona ili pismenim putem u zakonskom roku od kancelarije osoblja.

Kosovska Civilna Sluzba nudi jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Republike Kosovo su dobroprimljene prijave svih lica muškog i ženskog roda iz svih zajednica na Kosovo.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit –Ured Premijera –Office of the Prime Minister

Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Bazuar në nenin 8 pika 3.1, nenin 6 pika 5 dhe nenin 33 të Ligjit Nr.04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës, Udhëzimit Administrativ Nr.08/2012 për kushtet dhe Mënyrën e Ofrimit të të Dhënave të Fituarave me Përpunime të Veçanta të Statistikave Zyrtare si dhe nenin 12 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/ L -149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjin Nr. 04/L-077 Për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Agjencia e Statistikave të Kosovës, bënë:

Shpallje të Konkursit Publik për Marrëveshje për Shërbime të Veçanta

Emri i Institucionit	Agjencia e Statistikave të Kosovës
Titulli i punës:	Zhvillues i Aplikacioneve
Numri i referencës:	ASK-DMTI-001
Tarifa e shërbimit:	950 Euro (Bruto)
Raporton te:	Udhëheqësi i Divizionit të TI-së
Lloji i kontratës:	Marrëveshje për Shërbime të Veçanta - (MSHV)
Kohëzgjatja e kontratës:	2 muaj
Orari i punës:	1 plotë ?
Lokacioni dhe numri i ekzekutuesve:	ASK-1

ASK respektivisht Departamenti i DMTI-së është duke ndërtuar një sistem për Menaxhimin e Metadatave. Ky sistem do të jetë i kompatibil me sistemin e Eurostatit i tillë që do të mundësojë ASK-së që të dërgojë metadatat kombëtare në Eurostat përmes sistemit Metadata Handler (ESS-MH), dhe si i tillë do të jetë në përputhje me SDMX. Sistemi do të gjenerojë skedarë të metadatave në formatin .xml në përputhje me SDMX për të lehtësuar lidhjen me ESS-MH. Në mënyrë që ASK ti përmbush këto objektiva, shpall konkurs për një Zhvillues i Aplikacioneve.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Bashkërendon dhe ofron ndihmë për krijimin e strukturave dhe përmbajtjen e të dhënave të SDMX.
- Bashkëpunon me udhëheqësin e projektit për Metadata për tu siguruar që çdo çështje teknike të zgjidhet.
- Ndhmon në iniciimin e projekteve të reja të shkëmbimit të të dhënave në formatin SDMX.
- Merr pjesë në grupin e punës të SDMX dhe në grupet specifike të lidhura me detyrat e punës. Kjo përfshin bashkëpunimin me ekspertet e Eurostatit të nën kontraktuar nga GOPA për të hartuar udhëzime dhe dokumente të praktikave më të mira për përdorimin e SDMX.
- I ndihmohet dhe mbikëqyrur nga zyrtari përgjegjës i TI-së së ASK-së, do të zhvillojë një bazë të dhënash për metadatat në një server të dedikuar enkas për këtë qëllim.
- Ndërfaqja do të jetë bazuar në ESMS dhe ESQR.
- Ndërfaqja do të dizajnohet dhe zhvillohet në një ndërfaqe miqësore që do të jetë e lehtë për tu qasur;
- Bënë dokumentimin e projektit;
- Në mënyrë rigorozë zbaton masat e sigurisë dhe planeve të rikuperimit të të dhënave;
- Në mbikëqyrje të stafit lokal të TI-së, instalon, konfiguron dhe teston ueb aplikacionin në serverin e ASK-së;
- Bashkëpunon me grupet tjera punuese si dhe ndihmon në kontrollimin, krahasimin, analizimin dhe komentimin e të dhënave dhe rezultateve të tyre.

Shkathtësitë e kërkuara:

Diplomë Universitare në fushën e Teknologjisë Informative.
Së paku 4 vjet përvojë punë në fushën përkatëse (e obligueshme).

Kompetenca dhe aftësitë:

- Njohja e gjuhëve koduese siç: C#, HTML, CSS;
- Njohuri të avancuara në teknologjitë ASP .NET, MVC si dhe Microsoft SQL Server;
- Njohuri në standardet e SDMX përparësi;
- Shkathtësi në planifikim, hulumtim dhe analiza, kapacitet për të kuptuar proceset, për të koordinuar dhe organizuar punët;
- Ruajtja e konfidencialitetit;
- Të jetë i motivuar dhe aftësi për të punuar në atmosferë interdisciplinare;

Agjencia e Statistikave të Kosovës, mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore, nga të gjitha komunitetet.

Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë Qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësitë fizike që kërkojnë për pozitën përkatëse.

Konkursi është i hapur 5 ditë kalendarike nga dita e publikimit në media dhe në web faqen e ASK-se.

Paraqitja e kërkesave: Formularët për aplikim mund të merren në Arhivin e ASK-se, ose mund të tërhiqen nga web faqja e ASK-së në adresën <http://ask.rks-gov.net/>.

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Agjencinë e Statistikave të Kosovës, Rr."Zenel Salihu" nr.4 Prishtinë.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten: Kopja e letërnjoftimit, kopjet e dokumentacionit të kualifikimit, si dhe dokumentacionet tjera të nevojshme sipas konkursit.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara do të refuzohen.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtët do të kontaktohen.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të nënshtrohen intervistës me gojë.

Për informata të hollësishme, mund të kontaktoni në zyrën e personelit, në tel: 038- 20031149, prej orës 08:00 – 16: 00.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit –Ured Premijera –Office of the Prime Minister

Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Na osnovu člana 8. stava 3.1, člana 6, stava 5 i člana 33 Zakona br.04 / Z-036 o Zvaničnoj Statistici Republike Kosovo, Administrativnog Uputstva br.08 / 2012 o Uslovima i Načinu Pružanja Statističkih Podataka Dobijenih Posebnom Obradom Zvaničnih Statistika i člana 12 stava 4 Zakona br. 03 / Z-149 o Civilnoj Službi Republike Kosovo, Zakona br. 04 / Z-077 o Obligacionim Odnosima, Agencija za Statistiku Kosova, raspisuje:

Javni Konkurs o Sporazumu za Posebne Usluge

Naziv institucije:	Agencija za Statistiku Kosova
Naziv pozicije:	Razvijatelj/Developer Aplikacija
Referentni broj:	ASK-OMIT-001
Tarifa usluga:	950 Evra (Bruto)
Izveštava:	Šefu IT Divizije
Vrsta ugovora:	Sporazum za Posebne Usluge-(SPU)
Trajanje ugovora:	2 meseca
Radno vreme:	Puno ?
Lokacija i broj izvršilaca:	ASK-1

ASK, odnosno Odeljenje OMIT-a je u procesu izgradnje sistema za Upravljanje Metapodataka. Ovaj sistem će biti kompatibilan sa Eurostatovim sistemom koji će omogućiti ASK-u da prenosi nacionalne metapodatke Eurostatu kroz sistem Metadata Handler (ESS-MH), i kao takav će biti kompatibilan sa SDMX-om. Sistem će generisati datoteke metapodataka u .xml formatu u skladu sa SDMX kako bi se olakšala veza sa ESS-MH.

Da bi ASK ispunila ove ciljeve, raspisala je konkurs za jedan Razvijatelj (developer) aplikacija.

Zadaci i odgovornosti:

- Koordinira i pruža pomoć u kreiranju strukture i sadržaja SDMX podataka;
- Suraduje sa vođom projekta za metapodatke kako bi se osiguralo da su sva tehnička pitanja rešena;
- Pomaže u pokretanju novih projekata razmene podataka u SDMX formatu;
- Učestvuje u radnoj grupi SDMX-a i specifičnim podgrupama vezanim za radne zadatke. Ovo uključuje saradnju sa GOPA podugovornim stručnjacima Eurostata za izradu smernica i dokumenata najboljih praksa za korišćenje SDMX-a;
- Uz pomoć i nadgledanje od strane odgovornog IT službenika ASK-a će razviti bazu metapodataka na posebnom serveru specijalno posvećen za tu svrhu;
- Sučelje/Interfejs će biti baziran na ESMS i ESQR;
- Sučelje/Interfejs će biti dizajniran i razvijen u prijateljskom sučelju/interfejsu koji će biti lako dostupan;
- Izradi dokumentaciju projekta;
- Strogo sprovodi mere sigurnosti i planove obnavljanja podataka;
- Pod nadzorom lokalnog IT osoblja, instalira, konfigurira i testira veb aplikaciju na serveru ASK-a;
- Sarađuje sa drugim radnim grupama i pomaže u kontroli, upoređivanju, analizi i komentisanju njihovih podataka i rezultata.

Kvalifikacije:

Univerzitetska diploma iz oblasti Informacionih Tehnologija.

Najmanje 4 godine radnog iskustva u relevantnoj oblasti (obavežno).

Kompetencije i veštine:

- Poznavanje jezika kodiranja kao što su: C #, HTML, CSS;
- Napredno poznavanje tehnologije ASP. NET, MVC kao i Microsoft SQL Server;
- Poznavanje standarda SDMX-a prednost;
- Veštine u planiranju, istraživanju i analiziranju, sposobnost da razume procese, da koordinira i organizuje rad;
- Očuvanje povjerljivosti;

Agencija za Statistiku Kosova pozdravlja prijave svih muškaraca i žena iz svih zajednica.

Uslovi učešća na konkursu:

Pravo učešća na konkurs imaju svih punoletni građani Republike Kosova koji imaju punu sposobnost da deluju, koji su u posedu građanskih i političkih prava, koji imaju potrebnu obrazovnu spremu i stručnu sposobnost za obavljanje potrebnih zadataka i koji imaju fizičke sposobnosti potrebne za odgovarajuću poziciju.

Konkurs je otvoren 5 kalendarskih dana od dana objavljivanja u medijima i na veb- stranici ASK-a.

Podnošenje prijave:

Obrasci za prijavu mogu se dobiti u Arhivi ASK-a, ili se mogu preuzeti sa veb stranice ASK-a: <http://ask.rks-gov.net/>. Aplikacije se uzimaju i dostavljaju u Agenciju za Statistiku Kosova, Ul."Zenel Salihu" br.4, Priština.

Uz prijavu potrebno je priložiti: Kopiju lične karte, kopije dokumenata o kvalifikaciji i drugih dokumenata potrebnih za posao za koji se prijavljujete.

Nepotpune prijave i one *podnete* nakon isteka roka neće biti prihvaćene

Zbog velikog broja primljenih prijava, samo kandidati koji uđu u uži izbor biće kontaktirani.

Kandidati koji uđu u uži izbor biće usmeno intervjuisani.

Za dodatne informacije možete kontaktirati Kancelariju Osoblja na broj telefona: : 038- 200 31 149 od 08:00 – 16: 00 časova.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister

Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova - Kosovo
Agency of Statistics

Agjencia e Statistikave të Kosovës lidhur me Konkursin e jashtëm të publikuar në gazetën "Epoka e Re" më datën 05.04.2019, bënë këtë:

NJOFTIM

Mbi anulimin e konkursit për pozitën:

- Zhvillues dhe Administrator i Lartë i Sistemeve Softuerike
- Numri i Referencës: ASK-DMTI-se-001

Anulimi i këtij konkursi bëhet duke u bazuar në Raportin njoftues nga Komisioni Përzgjedhës i Rekrutimit në ASK-se, sipas Rregullores Nr.02/2010 të Procedurave të Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Ju falënderojmë për mirëkuptim.

Agjencia za Statistiku Kosova u vezi sa javnim konkursom objavljenom u dnevnom listu "Epoka e Re" dana 05.04.2019, objavljuje ovo:

OBAVEŠTENJE

O poništenju konkursa za poziciju:

- Programer/Developer i Viši Administrator Softverskih Sistema
- Referentni broj: ASK-OMIT-a -001

Poništenje ovog konkursa se vrši na osnovu Izveštaja o obaveštenju Komisije za Zapošljavanje i Selekciju Kandidata u ASK-u, po Uredbe br. 02/2010 o Procedurama Zapošljavanja u Civilnoj Službi.

Hvala na razumevanju!

Strana 1 od 1

Adresa: Ul. "Zemir Salihu" br. 4 - 10.000 Prishtina - Kosovo
Telefon: 038 235 111 xxxx / Faks: 038 235 033 / + 377 (0)44 xxxx xxxx
<http://www.ks-gov.net/esk>, e-mail: esk@ks-gov.net, e-mail : privat

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

Prishtinë



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Ermal Juniku shpall te pavlefshme diplomën shmit "11 Marsi" Prizren

► Valbona Bytyqi shpall te pavlefshme diplomën shmit "11 Marsi" Prizren

► Erzen Zoga shpall te pavlefshme diplomën shme "Ymer Prizreni" Prizren

► Laurena Dërmaku shpallë të pavlefshme diplomën e Kolegjit HEIMERER, Prishtinë.

► Bekim Hoti, student i fakultetit Juridik në Kolegjin "AAB", shpall të humbur ID kartelën e lëshuar nga fakulteti.

► Faik Hyseni shpall te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Dëshmorët e Qyqavicës" Qirez.

► Ganimete Zejnullahu shpall te pavlefshme diplomën e shkollës se mesme teknike "Anton Çetta" Skenderaj.

► Arsim Geci shpall te pavlefshme diplomën e shkollës se mesme profesionale QKS Skenderaj.

► Endrit Gashi shpallë të pavlefshëm dëftesat e klasës së: 10, 11, 12, dhe diplomën e sh. m. "Loyola Gymnasyun" - Prizren.

► "EURO-COD" SH.P.K shpallë të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 71249697 si dhe nr. fis. 601590517.

► N.SH. "A&D Projekt" shpallë të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 70265294

► Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçant me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Shitet banesa në Lakërishte përballë Procredit Bankës, hyrja e parë kati i 9 banesa ka 50m2 me dokumentacion të rregullt, çmimi 52 000€. Për info 044/672-439.

► Lëshohet me qira banesa në lakërishte afër Procredit bankës është e mobiluar 50m2 për një çift çmimi është 220€. Për irno 044/672-439.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Shes banesën hyrja e 7 mbi kurriz te banesat e gjelbërta përball shkollës "Xhemajl Mustafa" e rinovuar tërësisht. Banesa ka 82 metra katror. 3 dhoma, sallon, shpajz dhe ballkon + taras me shfrytëzim. Çmimi 75000 Euro me para te gatshme, por bej edhe ndërrim me banesë me të vogël në Prishtinë ose banesë më të madhe në Fushë Kosovë sipas marrëveshjes. Numri kontaktues: 044 672 439

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

Lumë's Details

Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lumë's Details

[lumesdetails](https://www.instagram.com/lumesdetails)

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

